

**GJYKATA E QARKUT NË PEJË**  
**Lënda P.nr. 445/09**  
**6 Prill 2011**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata e Qarkut në Pejë, trupi gjykues i përbërë nga Gjyqtari Malcolm Simmons si Kryetari i Trupit Gjykues dhe Gjyqtarëve Riku Jaakkola dhe Elmaze Syka si anëtar të trupit gjykues, procesmbajtës Tarik Mripa, në lëndën penale kundër

1. **Pal Pitaqaj**, i lindur me 30 Qershor 1963 në Gjakovë, me banim në rrugën "Pashko Vasa"nr. 47, Gjakovë, i biri i Kristit dhe nënës me emër dhe mbiemër të vajzërisë Hole Bashtotaj, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i 8 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, mekanik, pronar i hotelit "West Park", i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë më parë i dënuar, është mbajtur në paraburgim prej 7 Prillit 2007 deri më 2 Gusht 2007, aktualisht gjendet në liri.
2. **Aleksander Pitaqi**, 'Sander', i lindur me 10 Korrik 1977 në Gjakovë ku aktualisht banon në rrugën "Mbretëresha Teutë"nr. 69, i biri i Ndues dhe Pashkes, mbiemri i vajzërisë Shkreli, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, me arsimim të mesëm, tregtar, ish pronar i kafenesë 'AS', i gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë më parë i dënuar, është mbajtur në paraburgim prej 7 Prillit 2007 deri më 2 Gusht 2007, aktualisht gjendet në liri.
3. **Veronica Dragan**, e lindur me 24 Shtator 1981 në Falesti-Moldova, ku edhe banon në qytetin Ungr, rruga "Kristjuk", 4/a, apartamenti 7, e bija e Jurit dhe Lidijes, mbiemri i vajzërisë Ciuvaga, shtetase e Moldavisë, me arsimim fillor, e vejë, nënë e dy fëmijëve, kamarriere, e gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë e dënuar më parë, është mbajtur në paraburgim prej 10 Shtatorit 2001 deri më 27 Maj 2008, dhe përsëri nga 17 Qershori 2008 deri më 2 Dhjetor 2009, aktualisht gjendet në liri.

**4. Elena Pislaru**, e lindur me 14 Shkurt 1983 në Moldavi, tani banon në Gjakovë, rruga "Nena Terezë" pn, e bija e Vladimirit dhe Galines, mbiemri i vajzërisë Hrubit, shtetase e Moldavisë, me arsimim fillor, beqare, kamarriere, e gjendjes së varfër ekonomike, nuk ka qenë më parë e dënuar, është mbajt në paraburgim nga 29 shtatori 2007 deri më 26 tetor 2007, aktualisht gjendet në liri.

të akuzuar sipas Aktakuzës PP. Numër 37/2007 të datës 17 Dhjetor 2007, e përmirësuar me datën 22 Shkurt dhe 4 Prill 2011, me akuzat si më poshtë:

- kundër Pal Pitaqaj është Akuza 1 Trafikim i Personave sipas Nenit 139, (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe sipas Akuzës 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPK-së;

- kundër Aleksander Pitaqi, është Akuza 1 Trafikim i Personave sipas Nenit 139, (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, si dhe Akuza 2 Pastrim Parash sipas Seksioni 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut no.2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së;

- kundër Veronika Dragan sipas Akuzës 1 Trafikim i Personave sipas Nenit 139, (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, si dhe Akuza 2 Pastrim Parash sipas Seksioni 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut no.2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe

- kundër Elena Pislaru sipas Akuzës 1 Trafikim i Personave sipas Nenit 139, (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, si dhe Akuza 2 Pastrim Parash sipas Seksioni 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut no.2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së;

pas mbajtjes së gjykimit publik me datë 24 Nëntor 2010, 12, 20 dhe 24 Janar, 2, 21 dhe 22 Shkurt, si dhe 4 Prill 2011 ku Suad Kuraja paraqitet për Prokurorinë, Palët e Dëmtuara nuk ishin të pranishëm dhe nuk ishin të përfaqësuar,

Lumturije Hoxha paraqitet për Pal Pitaqaj, Haxhi Cekaj për Aleksander Pitaqi, Adem Gorani për Veronika Dragan dhe Zenel Mekaj për Elena Pislaru dhe gjatë gjithë kohës të Pandehurit ishin të pranishëm, me datë 6 Prill 2011 shpall publikisht këtë

## **AKTGJYKIM**

### Sipas Akuzës 1

**Pal Pitaqaj,**

Është

### **Fajtor**

Sepse:

Në Janar të vitit 2007 Pal Pitaqaj rekrutoi palën e dëmtuar duke ia paguar asaj shpenzimet e udhëtimit për të udhëtuar nga Moldavia për në Kosovë. Ajo u mashtrua nga Pal Pitaqaj duke besuar se po vinte në Kosovë për të punuar si kamariere. Pasi që arriti ajo u detyrua nga Pal Pitaqaj që të kryente shërbime seksuale me klientët e "West Park-ut". ishte ekonomikisht e cenuar dhe e varur kundrejt Pal Pitaqaj. Ai i kishte paguar asaj shpenzimet e udhëtimit dhe nga ajo kërkohej që ti shpaguante këto shpenzime nga fitimet e saja. Këto fitime përfshinin paratë e fituara nga kryerja e shërbimeve seksuale me klientët e West Park-ut. Pal Pitaqaj kishte pozitën e fuqisë kundrejt dhe ai keqpërdori këtë fuqi duke e shfrytëzuar atë për të kryer shërbime seksuale me klientët e West Park-ut.

Në këtë mënyrë ai kreu veprën penale *Trafikim i personave* sipas nenit 139 par. 1 të Kodit penal të Kosovës.

**Aleksander Pitaqi, Veronica Dragan dhe Elena Pislaru**

### **LIROHEN**

Sepse nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën penale sipas Akuzës 1 të Aktakuzës.

\* \* \*

Sipas Akuzës 2

**Aleksander Pitaqi dhe Veronica Dragan**

Janë

**Fajtor**

Sepse:

Nga Nëntori i vitit 2006 deri më 07 Prill 2007 në Gjakovë Aleksander Pitaqi transferoi nga Kosova tek Veronika Dragan përmes "Western Union", fonde në shumë prej 3.150 €. Gjatë periudhës së njëjtë kohore në Gjakovë Veronika Dragan transferoi 10.900 € tek marrës të ndryshëm në Moldavi për çka gjykata është e sigurt se së paku 6.000 € janë transferuar nga Veronika Dragan në emër të Aleksander Pitaqit.

Aleksander Pitaqi është kriminel i cili është i përfshirë të paktën në një biznes ilegal. Gjykata ka shikuar në çdo burim të mundshëm ligjor për të ardhurat e tij dhe konkludoj se të paktën 9,150 Euro janë të ardhura nga krimi.

Veronika Dragan është e dashura e Aleksander Pitaqit. Ai punoi në West Park. Ata i thanë gjykatës se kishin në plan të blinin pasuri së bashku në Moldavi. Ajo e dinte apo së paku kishte arsye të dinte se përqindja e transferimeve të parave që ajo bëri në emër të tij ishin të ardhura nga krimi, që do të thotë nga prostitucioni.

Gjykata konkludon se Aleksander Pitaqi, në iniciativë të përbashkët me Veronika Dragan, transferuar shumën prej 6,000 Eurove tek marrësit në Moldavi me qëllim të fshehjes së burimit të parave, e që ishin të ardhura nga prostitucioni dhe në kështu kanë përkrahur veprat e përmendura penale.

Kështu pra ata kryen veprën penale sipas Seksionit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, e përmirësuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Ne. 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.

**Elena Pislaru**

**LIROHET**

Sepse nuk është vërtetuar se ajo ka kryer veprën penale sipas Akuzës 2 të Aktakuzës.

\* \* \*

Sipas Akuzës 4

**Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqi,**

Janë

**Fajtor**

Sepse:

Gjatë periudhës kohore ndërmjet Nëntorit të vitit 2006 dhe 07 Prillit 2007, në lokalet e West Park-ut, në fshatin Lug Bunar, Komuna e Gjakovës, në bashkë-kryerje, në mënyrë të vazhdueshme me vetëdije kanë rekrutuar dhe organizuar vajza duke përfshi këtu dhe për qëllime të prostitucionit. Vajzat janë shitur tek klientët e West Park-ut për seks. Lokalet e West Park-ut gjendeshin brenda një sipërfaqeje më të vogël se 350 metra me shkollën fillore "Ahmet Rrustemi", në fshatin Lug Bunar.

Kështu ata kanë kryer veprën penale *Mundësim i Prostitucionit* sipas Nenit 201 par. 3 lidhur me par. 1 dhe 2 dhe lidhur me nenin 23 të KPPK-së;

Prandaj, në përputhshmëri me dispozitat e Neneve, 6, 11, 15, 31, 32, 33, 34, pikat 1, 2, 36, 38, 39, par 1, 2, 54, par 1, 2 pikat 9, 62, par 1, 2, 4, 64, par 1, 3, 65, par 1, 66, pikat 1, 2, 67 par 1, 2 pikat 2, 71 par 1, 2, pikat 2, 4, 5, 73, par 1, 99, par 1, 139, par 3 lidhur me par 1, 201 par 3 lidhur me par 1, 2 lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, Seksioni 10.2 (d), (e) i Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2004/2 i përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/53 Neni 99 par 1, 2 pika 99 par 1, 2 pikat 4 par 3, 102, par 1, 328 par 1, 385 par. 1, 2, 387 par 1, 2, 391 dhe 396 e

KPPK-së, gjykata jap dënimet si në vijim:

**Pal Pitaqaj,**

- Për veprën penale sipas Akuzës 1 dënohet me katër (4) vite burgim;
- Për veprën penale sipas Akuzës 4 dënohet me dy (2) vite burgim;
- Në përputhshmëri me nenin 71 par. 1 dhe 2 nën par. 2 të KPK-së, dënimi i unifikuar caktohet me pesë (5) vite burgim

**Aleksander Pitaqi,**

- Për veprën penale sipas Akuzës 2 dënohet me tre (3) vite burgim dhe dënimin me gjobë prej 12.000 €;
- Për veprën penale sipas Akuzës 4 dënohet me dy (2) vite burgim;
- Në përputhshmëri me nenin 71 par. 1 dhe 2 nën par. 2 të KPK-së, dënimi i unifikuar u caktua me katër (4) vite burgim dhe gjobën prej 12.000 €.

**Veronica Dragan,**

- Për veprën penale sipas Akuzës 2 dënohet me dy (2) vite burgim dhe gjobë prej 6.000 €

Kundër të pandehurës Veronica Dragan, në pajtim me nenin 54 par. 1 dhe 2 nën par. 9 të KPPK-së, dënimi dytësor për Dëbim nga territori i Kosovës vihet për periudhën kohore prej pesë (5) viteve. Urdhëresa në fjalë do të ekzekutohet brenda 48 orëve nga dita që ky aktgjykim behet i plotfuqishëm.

Koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit e dënuar Pal Pitaqaj dhe Alkesander Pitaqi, nga data 07.04.2007 deri më datën 02.08.2007 dhe e pandehura Veronica Dragan nga data 10.09.2007 deri më datën 27.05.2008 dhe nga data 17.06.2008 deri më datën 02.12.2009, do të llogaritet në dënim.

Secili nga të pandehurit e dënuar do të paguajnë shpenzimet

e procedurës gjyqësore në shumë prej 1.000€ dhe shumen e përbashkët prej 200€ secili.

Pala e dëmtuar mund të parashtroj padi për kompensim përmes gjykatës civile.

Aktgjykimin me shkrim do të dorëzohet brenda 30 ditëve.

Palët janë të obliguara që brenda tetë ditësh të njoftojnë për çfarëdo ankese.

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër këtij aktgjykimi.

Secila ankesë kundër Aktgjykimit të lëshuar nga gjykata e shkalles së parë duhet të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit në fjalë.

Të Pandehurit janë të obliguar të njoftojnë gjykatën për çfarëdo ndryshimi të adresës deri sa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

## **ARSYETIM**

### **A. Prapavija Procedurale**

#### **i. Aktakuza**

Aktakuza PP. numër 37/2007 e datës 17 Dhjetor 2007 akuzoi gjashtë të pandehur. Aktakuza u vërtetua me datë 20 Shkurt 2008.

I Pandehuri i Parë u akuzua sipas Akuzës 1 për Trafikim Personash sipas Nenit 139, (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së; i Pandehuri i Dytë u akuzua sipas Akuzës 1 për Trafikim Personash sipas Nenit 139, (1) dhe (3) të KPPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, sipas Akuzës 2 Pastrim Parash sipas Nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe Akuzën 4 Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së; e Pandehura e Tretë u akuzua sipas Akuzës 1 për Trafikim Personash sipas Nenit 139, (1) dhe

(3) të KPPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 2 Pastrim Parash sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe e Pandehura e Katërt u akuzua me Akuzën 1 për Trafikim Personash sipas Nenit 139, (1) dhe (3) të KPPK-së, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe sipas Akuzës 2 Pastrim Parash sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2004/02 e përmirësuar me rregulloren e UNMIK-ut 2006/53, lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.

E pandehura e pestë, \_\_\_\_\_ u akuzua për Trafikim Personash sipas Nenit 139 (1) dhe (3), lidhur me Nenin 23 të KPPK-së dhe Pastrim Parash sipas Nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/02 e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/53 lidhur me Nenin 23 të KPPK-së. Para fillimit të gjykimit të parë Tatjana Ciuvagu iku nga autoriteti i kësaj gjykate. Me 4 Shkurt 2008 ajo u nda nga kjo procedure gjyqësore.

I pandehuri i gjashtë, \_\_\_\_\_, u akuzua për veprën penale Mundësim i Prostitucionit sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) të KPPK-së lidhur me Nenin 23 të KPPK-së.

Me datë 27 Maj 2008, sipas Nenit 390 (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje "KPPK"), \_\_\_\_\_ j u lirua nga akuza për këtë akuzë. Kundër këtij lirimi nuk u parashtrua asnjë ankesë nga Prokuroria.

## **ii. Kompetencat e Gjykatës dhe Përbërja e Trupit Gjyqësor**

Në përputhshmëri me Nenin 23 (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut ka kompetence për të gjykuar në shkallen e parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vite burgim apo ato vepra të dënueshme me burgim të gjatë.

Në rastin aktual të pandehurit janë akuzuar për Trafikim Personash në bashkëveprim në kundërshtim me Nenin 139 (1) dhe (3) lidhur me Nenin 23 të KPPK-së, vepër penale e dënueshme me gjobë deri në 500,000 Euro dhe me burgim deri në njëzet vite burgim; Pastrim Parash në kundërshtim me Nenin 11.2 pikat a, b, d dhe e të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2, (e përmirësuar me seksionin 1 pikën k të UNMIK/REG/2005/9 dhe e ri-shënuar sipas pikës h, fjalia e fundit e UNMIK/REG/2006/53) dhe Neni 23 e KPPK-së, një vepër penale e dënueshme me burgim deri në dhjetë vite dhe

me gjobë sa tri herë që është vlera e pronës që është objekti i veprës penale; dhe Mundësim i Prostitucionit në kundërshtim me Nenin 201 (3) dhe (1) dhe Nenin 23 të KPPK-së, veprë penale e dënueshme me burg prej një deri në tetë vite.

Veprat penale, sipas Aktakuzës, ishin kryer në Gjakovë, e që është territor i Gjykatës së Qarkut të Pejës. Kështu pra, në përputhshmëri me Nenin 27 (1) të KPPK-së, Gjykata e Qarkut në Pejë ka kompetenca territoriale për të gjykuar këtë lëndë.

Nuk ka pasur asnjë mospajtim nga palët sa i përket kompetencave të kësaj Gjykate.

Veç kësaj, sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Kompetencat Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (tani e tutje "LK"), gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedura gjyqësore penale kanë autorizim dhe kompetenca mbi çfarëdo rasti të hetuar apo të ndjekur penalisht nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës.

Pasi që lënda në fjalë është hetuar dhe aktakuza është parashtruar nga Prokurori Special i Kosovës Trupi Gjykses i Gjykatës së Qarkut në Pejë është kompozuar në mënyrë të drejtë si trup gjykses i përzierë nga dy Gjyqtar të EULEX-it dhe një Gjyqtar vendor në përputhshmëri me nenin 4.7 të LK-së.

Nuk ka pasur asnjë mospajtim nga palët sa i përket përbërjes së kësaj Gjykate.

### **iii. Gjuha**

E pandehura e tretë dhe e Katërt janë Moldave. Të dy të pandehurat si dhe mbrojtësit e tyre njoftuan gjykatën se ato e kuptojnë gjuhen Serbe. Pasi që kjo u hetua trupi gjykses konkludoj se ata janë në gjendje të kuptojnë gjuhen Serbe dhe se plotësisht mund të ndërliken në procedurën gjyqësore përmes përkthyesit Serb të cilin e siguroj gjykata.

### **B. Shqyrtimi Kryesor**

## **i. Dëshmitë e administruara gjatë shqyrtimit kryesor**

Gjatë vazhdës së shqyrtimit kryesor janë dëgjuar këta dëshmitarë dhe janë administruar këto dëshmi

### Dëshmia e dëshmitarit

1. Dëshmitari dëshmoi me 12 Janar 2011;
2. Dëshmitari dëshmoi me 12 Janar 2011;
3. Dëshmitari dëshmoi me 02 Shkurt 2011;
4. Dëshmitari dëshmoi me 02 Shkurt 2011;
5. Dëshmitari dëshmoi me 21 Shkurt 2011;
6. Dëshmitari dëshmoi me 21 Shkurt 2011;
7. Dëshmitari dëshmoi me 21 Shkurt 2011.

### Deklaratat e lexuara të dëshmitarit

1. Deklarata e e datës 23 Janar 2007
2. Deklarata e e datës 08 Prill 2007
3. Deklarata e e datës 17 Prill 2007
4. Deklarata e e datës 10 Maj 2007
5. Deklarata e e datës 08 Prill 2007
6. Deklarata e e datës 17 Prill 2007
7. Deklarata e e datës 23 Nëntor 2007
8. Deklarata e e datës 20 Maj 2008
9. Deklarata e e datës 23 Nëntor 2007
10. Deklarata e e datës 23 Nëntor 2007
11. Deklarata e e datës 16 Korrik 2007
12. Deklarata e e datës 15 Shtator 2007
13. Deklarata e e datës 16 Korrik 2007
14. Deklarata e e datës 09 Prill 2007
15. Deklarata e e datës 20 Maj 2008
16. Deklarata e e datës 03 Maj 2007
17. Deklarata e e datës 16 Korrik 2007
18. Deklarata e e datës 03 Maj 2007
19. Deklarata e e datës 16 Korrik 2007
20. Deklarata e e datës 08 Prill 2007
21. Deklarata e e datës 19 Prill 2007
22. Deklarata e e datës 16 Janar 2007

### Dokumentacioni i dëshmimeve

1. Raport i Shpejtë Policor numër 2007-DI-056 i datës

16.01.2007;

2. Raport i Policis rasti no. 2007-DI-056 i datës 17.01.2007 përpiluar nga polici Sali Shoshi #6257

3. raport hetues mbi zbatimin e masave të fshehta të vrojtimit të Klubit të Natës West Park i datës 06.02.2007 përpiluar nga dy polic, me numër kodi 0001 dhe 0002

4. Kallëzim Penal Policor kundër Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqaj, rasti numër 2007-DI-056 i datës 10.04.2007, përpiluar nga polici Sali Shoshi #6257

5. Raport Policor mbi zbatimin e masave të fshehta të datës 08.04.2007, përpiluar nga #2027 dhe #2201

6. Fotokopje të parave të përdoruar për blerje të stimuluar; dy bankënota prej 100 euro dhe katër bankënota prej 50 euro, të cilat janë bashkangjitur këtij kallëzimi penal

7. fotografi të Klubit të Natës West Park nga brendësia dhe nga jashtë të cilat janë bashkangjitur këtij kallëzimi penal

8. Procesverbal i takimit të këshillit të shkollës ku shprehet pakënaqësia e printerëve, personelit arsimor dhe këshillit të shkollës për hapjen e një shtëpie publike afër shkollës fillore, e bashkangjitur këtij kallëzimi penal

9. Tre CD-e me përmbajtje të diskutimeve në mes oficerëve të policisë që kanë kryer masat e fshehta dhe Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqaj. CD-ja e parë quhet Koha e Arrestimit, CD-ja e dytë Biseda me Pronarin dhe CD-ja e tretë Marrëveshja me Pronarin e klubit

10. Transkripti i CD-ve

11. Kontratë punësimi në mes Pal Pitaqaj si pronar i Klubit të Natës West Park në Gjakovë dhe Elena Pislaru e datës 08.09.2006

12. Kontratë punësimi në mes Aleksander Pitaqaj si pronar i Klubit të Natës AS në Gjakovë dhe Veronica Dragan e datës 06.02.2006

13. Ekstrakt nga libri i regjistrimit të Hotelit Metropol-City
14. Dokumente nga Departamenti për Regjistrim, Gjendje Civile dhe Dokumente Civile
15. Raport i Policisë së Aeroportit i datës 03.07.2007 mbi lëvizjet e udhëtimit të Elena Pislaru, ,  
 , Veronica Dragan dhe
16. Gjendja e Taksa paguesit për Kompaninë "Dardania" me pronar Pal Pitaqaj
17. Raport i Administratës Tatimore të Kosovës mbi gjendjen e tatimit të klubit të natës Dardania - pronar Pal Pitaqaj dhe AS - pronar Aleksander Pitaqaj
18. Certifikatë e Regjistrimit të Biznesit të klubit të natës Dardania me pronar Pal Pitaqaj
19. Certifikatë e Regjistrimit të Biznesit të klubit të natës AS me pronar Aleksander Pitaqaj
20. Forma e paraqitjes së punëtorëve të Klubit të Natës AS për , dhe me punëdhënësin Aleksander Pitaqaj
21. Raport i Agjensionit Kosovar të Kadastres mbi patundshmërinë e Pal Pitaqaj
22. Raport i Post-Telekomunikacionit të Kosovës i datës 19.07.2007 mbi listingun dhe përgjimin e numrit 044/635-556 nga data 01.01.2007 deri me datë 17.06.2007 si dhe përmbajtja e SMS mesazheve
23. Raport i Post-Telekomunikacionit të Kosovës i datës 26.04.2007 mbi listin e numrit 044/ dhe 044/ nga data 01.01.2007 deri me datë 10.04.2007
24. Raport i ProCredit Bankës së datës 23.05.2007 për nxjerrjen e të dhënave financiare të xhirollogarisë së Pal Pitaqaj
25. Raport i Raiffeisen Bank i datës 23.05.2007 për nxjerrjen e të dhënave financiare të xhirollogarisë së Pal Pitaqaj

26. KasaBank për nxjerrjen e të dhënave financiare të xhirologarisë së Pal Pitaqaj
27. Raport i Unionit Financiar të Prishtinës i datës 27.09.2007 mbi të dhënat financiare të Western Union; transaksionet e bëra nga Veronica Dragan dhe fotokopjet e formave të dërgimit të parave nga Veronica Dragan
28. Raport i Unionit Financiar të Prishtinës i datës 27.09.2007 mbi të dhënat financiare të Western Unionit per transaksionet e bëra nga Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqaj, si dhe listën e transaksioneve
29. Njoftimin e Administratës Tatimore të datës 27 Janar 2011
30. Raporti i Prokurorisë mbi Transferimin e Parave nga të Pandehurit të datës 8 Shkurt 2011

## **ii. Dëshmia e dëshmitarit**

Prokuroria thirri . Ai dëshmoi me datë 21 Maj 2008 në gjykimin e parë të të Pandehurve. Ai dha deklaratë tek Prokurori Special me datë 17 Dhjetor 2007.

Ai dëshmoi para kësaj gjykate me 12 Janar 2011. Ai tha se e njeh të dy të pandehurin e parë dhe të dytë. Ai tha se ishin të njohur. Ai tha se nuk shoqërohej me ta.

Ztr. dëshmoi se në disa raste kishte pirë në kafenenë e të Pandehurit të parë. Ati nuk k kujtohet emri i kafenesë. Në përgjigje të pyetjes së parashtruar nga Prokurori Ztr. dëshmoi se e dinte që i pandehuri i dytë ishte pronar i kafenesë "AS" dhe se e kishte vizituar këtë lokal në disa raste.

Ztr. e dinte se vajzat Moldave ishin të punësuar në të dyja lokalet. Ai mohoi të iu kishte afruar ndonjëherë shërbimi nga vajzat në cilindo lokal.

Kur është dëgjuar nga Prokurori me datë 17 Dhjetor 2007 ai se si kishte paguar afro 1,200 Euros për dhe të pandehurën e tretë që vinte në Kosovë nga Moldavia. Ai tha se e takoi afërsisht një vit përpara se ajo të punonte në "AS". Ai tha se ia kishte qar parat përmes Western Union.

Prokurori thirri . Ai dëshmoi me datë 21 Maj 2008 n.7 gjykimin e parë të të pandehurve. Ai dha deklaratë në polici me datë 19 Prill 2007 dhe tek Prokurori Special me 12 Dhjetor 2007. Ai dëshmoi para kësaj gjykate me 12 Janar 2011.

Ai tha se i kishte njohur të dy të të pandehurit të parin dhe të dytin që nga viti 1999. Ai dëshmoi se nuk e kishte ditur se i pandehuri i parë ishte pronari i "West Park-ut" apo se i pandehuri i dytë ishte pronar i "AS-it". Ai nuk mban të ketë qenë në asnjërin prej këtyre dy kafeneve.

Ztr. dëshmoi para kësaj gjykate me 7 Prill 2007 ai po punonte në Hotelin Metropol në Gjakovë.

Diku pas orës 11 të mbrëmjes ai dëgjoi një trokitje në derë. Ai pa dy burra dhe dy femra duke pritur jashtë. Ai tha se nuk i njohu. Kjo e kundërshtoi atë që i tha policisë me 19 Prill 2007. Me atë rast ai u pyet se nëse kjo ishte hera e parë që këto dy femra kishin qenë në hotel. Në përgjigje të kësaj ai tha:

*"Jo ata ishin mysafire shumë herë"*

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai mohoi të kishte pa të pandehurin e parë apo të dytë në hotel me 7 Prill 2007. Sido që të jetë, kjo gjithashtu kundërshtoi deklaratën e tij të dhënë në polici me 19 Prill 2007. Në atë deklaratë ai tha

*"Pal Pitaqi ishte po ashtu jashtë duke ndenjtur afër veturës në një largësi për afërsisht dhjetë metra nga hoteli; ai nuk më tha mua asgjë"*

Ztr. u pyet lidhur me këtë mospërputhje. Ai tha se policia ishte sjell keq me te. Edhe pse, ai nuk ia doli ta bindte Gjykatën se trajtimin që kishte marrë nga policia ishte aq i keq sa që dëshmia e tij ishte e qëndrueshme. Deklarata e tij përfshinte edhe një deklaram se kjo po bëhej me dëshirë dhe pa asnjë ushtrim të presionit.

Ai tha se foli me njërin nga burrat i cili kërkoj dy dhoma. Ztr. tha se ia tregoi çmimin këtij burri dhe se ju kërkoj dokumentet e tyre. Çmimi për secilën dhomë ishte 20 Euro.

Grupi vazhdoj për tek kati i dytë ku njeri nga burrat pagoi për të dy dhomat duke afruar bankënote prej 50 Eurosh. Ztr. ia kthej 10 Euro kusur. Që të katërt hyn në njërin prej dhomave. Ztr. dëshmoi se ai dëgjoi një zhurmë poshtë dhe shkoi për të pyetur. Ai rrugës u ndesh në polic të cilët e përcollën deri tek dhoma ku i kishte lënë mysafiret. Ztr dëshmoi se, sipas kërkesës së policisë, ai e kthej bankënotën prej 50 Euro të cilën e kishte marr si pagesë për dy dhomat.

Ai dëshmoi se pa të dytë, të pandehurin e parë dhe të dytë "shumë herë" në hotelin Metropol.

Kur u morë në pyetje nga policia me datë 19 Prill 2007 ai u pyet se sa herë në të shkuarën ai kishte parë të pandehurin e dytë para hotelit duke sjell vajza. Në përgjigje ai tha

*"...Unë merresha vetëm me mysafirët që kërkonin dhomë por në kohën kur unë hapa derën unë pashë femrat dhe meshkujt kurse Aleksander Pitaqin e kam parë shumë herë me veturë..."*

Kur u pyet nga policia me datë 19 Prill 2007 ai u pyet se sa herë përpos asaj nate të datës 7 Prill 2007 ai kishte parë të pandehurin e parë para hotelit. Në përgjigjen e tij Ztr. deklaroi

*"Gjithashtu gjersa hapja derën për mysafirët me femrat unë kam parë Palin në hotel disa herë"*

Në deklaratën e tij të datës 19 Prill 2007 Ztr. i referohet një rasti kur dy femra qëndruan në hotel për 5 ditë. Ai u pyet nëse e dinte se ku punonin këto vajza. Në përgjigjen e tij ai tha

*"po, njëra nga to që qëndroi në hotel për pesë ditë unë e di që ajo është njëra nga punëtoret e Aleksandrit dhe Palit..."*

dhe  
, në gjykimin e parë, nuk ishin në Kosovë dhe/ose vendndodhje e tyre nuk dihej. Asnjëra nga këto dëshmitare nuk dëshmoi para kësaj gjykate.

Prokuroria vuri si dëshmi deklaratat e para të dëshmitares

të datës 9 Prill 2007 respektivisht të datës 16 Korrik 2007. Procesverbali i dëshmisë së saj të datës 20 Maj 2008 para gjykatës në gjykimin e parë të të pandehurve po ashtu janë futur në dëshmi.

Me marrëveshjen të Prokurorisë dhe avokateve mbrojtës dëshmia e saj paraprake është pranuar si dëshmi në pajtim me Nenin 368 të Kodit të Procedurës Penale.

deklaroi se kishte marrë përpilimin e kontratës përmes . Ishte me të cilën ajo, me sa duket, kishte diskutuar punën në Kosovë. Kontrata ishte dërguar me faks. Ajo tha se kushtet e kontratës ishin që ajo do të punonte si kamarriere dhe do të merrte rrogë mujore prej 200 Eurosh<sup>1</sup>. Ajo tha se me të arritur në Kosovë ajo nënshkroi një kontratë të dytë me të pandehurin e parë.

përshkroi se si në Mars 2007<sup>2</sup> ajo udhëtoi për në Kosovë me . Në Aeroportin e Prishtinës atë e prití i pandehuri i parë dhe e pandehura e tretë. Ajo tha se udhëtoi për në Kosovë me biletën të cilën e kishte blerë 'vetë' me para 'të veta'. Ajo tha se zuri punë si kamarriere në West Park. Ajo tha se ajo punonte atje vetëm për afro një javë. Ajo tha se kishte liri të lëvizjes. Ajo mohoj se ishte detyruar nga i pandehuri i parë që të kishte marrëdhënie seksual me klientë.

Duke iu referuar ngjarjeve të 7 Prillit 2007 ajo tha se po punonte në West Park nga ora 6pasdite deri në mesnatë. Ajo nuk mban mend se a ishte i pandehuri i parë dhe i dytë aty.

Prokuroria fut si dëshmi procesverbalin e shqyrtimit të dëshmitares të dhënë me datë 23 Nëntor 2007. Avokatet mbrojtës nuk ishin të pranishëm në atë shqyrtim. Procesverbali i dëshmisë së saj të datës 20 Maj 2008 para gjykatës në gjykimin e parë të të pandehurve po ashtu është pranuar si dëshmi.

Me marrëveshje të Prokurorisë dhe avokateve mbrojtës dëshmia e saj paraprake është pranuar si dëshmi sipas Nenit 368 të Kodit të Procedurës Penale.

Natalija Drosu përshkroi se si erdhi në Kosovë në Shkurt të

<sup>1</sup> Në deklaratën e saj të datës 16 korrik 2007 ajo tha 200 Euro. Kur dëshmoi me 20 Maj 2008 ajo tha 150 Euro.

<sup>2</sup> Në deklaratën e 9 Prill 2007 ajo tha se arriti në Kosovë me 30 Mars 2007. Në deklaratën e 16 korrikut 2007 ajo japi datën si 27 Mars 2007. Kur dëshmoi me 20 Maj 2008 ajo tha se arriti me 28 Mars 2007.

2006. Ajo tha se që të vinte në Kosovë ia kishte mbushur mendjen Tatjana Ciuvagu.

Kur ai u dëgjua me 23 Nëntor 2007 ajo tha

*"unë erdha në Kosovë me Veronika Dragan dhe Aleksander Pitaqaj po na priste **neve** në aeroport". Megjithatë, kur ajo dëshmoj me datë 20 Maj 2008 ajo dëshmoi "erdha në muajin Shkurt të 2006. Aleksander më priti **mua** në aeroport. Ai ishte vetëm. Unë mendoj se ishte vetëm, nuk më kujtohet shumë mirë. po, ishte edhe Veronika **me** Aleksandrin në aeroport."*

Nga dëshmia e saj duket se ajo u takua ë aeroport me të pandehurin e dytë dhe të tretë. Megjithatë, dëshmia e saj lidhur me këtë është disi e dyshimtë. Ajo tha se udhëtoi për në Kosovë me biletën të cilën e kishte blerë me para të 'veta'.

Ajo tha se ishte punësuar nga i pandehuri i dytë si kamarriere. Ajo tha se kishte kontratë Kontratën ia kishin dërguar me faks në Moldavi. Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo filloi së punuari te "AS-i" një dite pas arritjes. Ajo tha se kishte liri lëvizjeje. Kur u morë në pyetje me datë 23 Nëntor 2007 ajo tha

*"ne nuk guxonim të dilnim pa lejen e Aleksandër Pitaqit, nuk dalim fare pa lejen e tij, edhe atë një herë në javë të gjitha vajzat bashkë, nuk guxonim të ndaheshim njëra nga tjetra, merrnim taksì për të shkuar në qytet dhe gjatë gjithë kohës ishim nën vëzhgim të Aleksandër Pitaqit. Gjatë gjithë kohës ishim të frikësuara ai na bërtiste por nuk na rrihte."*

Ai tha se punoi për të pandehurin e dytë për gati 6 muaj. Ajo tha se po ashtu "vallëzonte në shtizë". Ajo tha se klientët e paguanin atë 20 - 30 Euro për secilin vallëzim. Ajo vlerësoi se fitoi 3000 - 4000 Euro për gjashte muaj që punoi tek i pandehuri i dytë.

Ajo tha se parat e fituara ajo i transferoi përmes Western Union tek familja e saj në Moldavi. Kur u morë në pyetje me datë 23 Nëntor 2007 ajo pranoi se ia kishte dërguar 1100 . Ajo tha se parat ishin për të ja kthyer asaj për blerjen e biletës së aeroplanit dhe 100 të tjera ishin që t'ia jepte nënës së Znj. . Ajo tha se ajo dërgoi edhe 600 Euro për Elena Pislaru.

Këto, tha ajo, ishin hua. Ajo dërgoi edhe 700 Euro .  
. Këto gjithashtu ishin, me sa duket, një hua.

Ajo mohoi se i pandehuri i dytë i kishte dhënë asaj para për ti dërguar në Moldavi.

Ajo mohoi se ishte detyruar nga i pandehuri i dytë të kishte marrëdhënie seksuale me klientë.

Prokuroria futi në dëshmi procesverbalin e marrjes në pyetje të të datës 17 Prill 2007 dhe 10 Maj 2007. mbrojtja e të pandehurit të parë dhe të dytë ishin të pranishëm gjatë të dy marrjeve në pyetje dhe i kanë parashtruar pyetje dëshmitares. Ajo po ashtu dha deklaratë në polici me 8 Prill 2007.

Me marrëveshje të Prokurorisë dhe avokatëve mbrojtës dëshmia e saj paraprake është futur në dëshmi sipas Nenit 368 të Kodit të Procedurës Penale.

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007 ajo deklaroi se arriti në Kosovë për herë të parë në Shkurt të 2006. Ajo qëndroi gjashtë muaj para se të kthehej në Moldavi

Atë e priti në Aeroportin e Prishtinës i pandehuri i dytë dhe e dërgoi në një apartament. Ajo punoi për të pandehurin e dytë në kafenenë "AS" për afro gjashtë muaj. Ajo deklaroi se gjatë kësaj kohe asaj nuk i është kërkuar që të siguroi ndonjë shërbim seksual për klientët.

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007, lidhur me udhëtimin e saj të parë në Kosovë, ajo tha

*"...mora para nga motra ime, bleva biletën dhe erdha në Kosovë me "*

Gjykata konkludon se " " është .

dëshmoi me 17 Prill 2006 se në Shtator 2006 ajo foli përsëri me e cila i propozoj të kthehej në Kosovë për të punuar si kamarriere.

Në intervista e saja në vazhdim me datë 17 Prill dhe 10 Maj 2007 nuk ka dallime të pavarura në mes hyrjes së parë dhe të dytë në Kosovë të Znj. .

Kur u pyet nga Prokurori lidhur me blerjen e biletës kur

ajo udhëtoi nga Moldavia për në Kosovë, lidhur me të pandehurin e parë, Znj. dëshmoi

*"...huazova para nga motra ime për të ia kthyer atij"*

Ajo u kthye në Kosovë në Tetor 2006. Në deklaratën e saj të datës Prill 2007 ajo tha se atë e kishin pritur në aeroport i pandehuri i parë dhe i dytë<sup>3</sup>. Kur deklaroi me 17 Prill dhe me 10 Maj 2007 ajo tha se atë priten në aeroport i pandehuri i parë dhe .

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007, lidhur me hyrjen e saj të dytë në Kosovë, ajo tha se fillimisht punoi për të pandehurin e dytë në "AS". Ajo deklaroi

*"Pas disa ditësh Aleksandri e ndërroi biznesin e tij dhe pronar ishte Pal Pitaqi. Kafeneja quhej "West Park".*

Sajo filloi të punoi për të pandehurin e parë në "West Park" ditën e nesërme. Ajo u punësua si kamarriere nga i pandehuri i parë.

Para se ajo të arrinte në Kosovë përmes faksit ajo kishte marrë një kontratë. Paga ishte 150 Euro për muaj. Orari i zakonshëm i punës për te ishte nga ora 6 pasdite deri në mesnatë.

Në përgjigje të pyetjes së prokurorit lidhur me atë se a kishte shërbime të tjera që kërkoheshin nga dëshmitarja për të kryer lidhur me të pandehurin e parë, Znj. dëshmoi

*"Ai më tha nëse nuk kryen shërbime të tjera to do të shkosh në shtëpi. Një kamarriere duhej të kryente shërbime të tjera të ofruara nga pronari i kafenesë West Park"*

...

*"Ai më tha: "Ti duhet të punosh përndryshe do të largohesh"*

Ajo dëshmoi

*"...Pal shkante dhe bisedonte me klientë të ndryshëm"*

---

<sup>3</sup> Deklarata e 8 prillit 2007

*që ishin të ulur në tavolina dhe pasi binte në ujdi me ta ai më thoshte të vishesha dhe të shkoja me ta"*

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007 ajo tha

*"Pali gjithmonë i zgjidhte myshterinjtë..."*

...

*"Parat gjithmonë i merrte Pali dhe unë mendoj se ai i merrte 100 Euro nga një klient"*

Ajo tha se paguhej ekstra për të kryer këto shërbime.

*"Për secilën marrëdhënie seksuale që ti do të kesh, më thoshte Pali, ti do të marrësh 50 Euro dhe unë do të marr 50 Euro si pronar i kafenesë"*

Ajo deklaroi se gjatë kohës kur ajo punoi për të pandehurin e parë ajo pati marrëdhënie seksuale përafërsisht me 15 klientë. Kur u morë në pyetje me 17 Prill 2007, lidhur me periudhën kohore paraprake prej 6 - 7 muajsh ajo vlerësoi se kishte qenë me 5 apo 6 klientë.

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007

Prokurori: *"Kur arrite në Kosovë a e dije se Pali do të kërkonte nga ti që të përfshiheshe në prostitucion?"*

: *"Jo nuk e dija sepse ai më kishte premtuar se unë do të punoja si kamarriere..."*

Kur deklaroi me datë 17 Prill 2007 ajo tha

*"Kur arrita në Kosovë, pronari i kafenesë Pal Pitaqi më pyeti nëse, përpos punës sime të rregullt si kamarriere do të beja edhe punë të tjera - prostitucion, unë e pranova këtë propozim dhe kështu fillova të beja prostitucionin përpos punës sime si kamarriere."*

Në raportin e tij të datës 17 Janar 2006<sup>4</sup> Oficeri Sali

---

<sup>4</sup> Data e raportit duhet të jetë 17 Janar 2007 sespe i referohet ngjarjeve në vitin 2007

Shoshi përshkroi se policia kishte intervistuar punëtoret femra të West Park me 23 Janar 2007. Mes këtyre punëtoreve të intervistuara ishte . Nuk ka shënim tekstual fjalë për fjalë se çka në fakt secila punëtore i ka thënë policisë. Megjithatë raport thotë "të gjitha deklaruan se nuk keqtrajtoheshin apo detyroheshin për të ushtruar prostitucionin nga ana e pronarit apo personave të tjerë". Nga raporti i policeve del se të njëjta punëtore janë intervistuar prapë me datë 12 Shkurt 2007 kur edhe kanë bere të njëjtat deklarime.

Kur është pyetur për lirinë e saj të lëvizjes, Znj. deklaroi:

*"Gjatë kohës së tyre të lirë gjersa ishin ne shtëpitë e tyre, viktimat nuk guxonin të dilnin pa kontaktuar pronarin e kafenesë Pal Pitaqi dhe pa marr lejen e tij"*

Ajo më vonë e cilësoi këtë duke thënë se kjo ishte për "shkqaj të sigurisë".

Në përgjigje të pyetjes së avokatit mbrojtës Znj. dëshmoi

*"ne ishim të lira; ne dilnim dhe pinim kafe në restorante"*

Kur u dëgjua me datë 17 Prill 2007 Znj. deklaroi

*"...gjatë asaj dite, e kjo është, deri në ora 18:00, ne ishim të lira, ne mund të shëtisnim neper qytet dhe askush nuk na ndalonte që të largoheshim nga kafeneja."*

Lidhur me ngjarjet e datës 7 Prill 2007 Znj. deklaroi:

*"...Atë natë Pali erdhi në kafene dhe na tha të visheshim. Ne u veshëm, merrem xhaketat dhe na tha të shkonim në veturë. Ne shkuam me veturë në drejtim të hotelit Metropol në Gjakovë."*

Kjo përputhet me deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007. Në atë deklaratë ajo deklaroi se i pandehuri i parë e qoi atë dhe " " te Hoteli Metropol.

Kur u pyet nga Prokurori se kush kishte folur me klientët

në tavolinë Znj. deklaroj

*"Pali ishte ai i cili e hyri dhe beri marrëveshje. Aleksandri hyri u ulë dhe pastaj doli, ndërsa Pali ishte ai i cili na qoi në hotel"*

...

*"ne ishim të paret që u afruam tek hyrja e hotelit me Palin. Pastaj Pali u largua me veturë, pastaj klientët arritën dhe ne shkuam me ta lart"*

Ajo dëshmoi se ajo nuk e kishte parë të pandehurin e parë që ka marr pagesën.

Znj. u pyet nga Prokurori se a kishte kërkuar i pandehuri i parë apo i pandehuri i dytë nga ajo që të kryente shërbime të tjera. Në përgjigjen e saj Znj. dëshmoi

*"Po. Vetëm Pali. Ai ishte shefi".*

Atë e pyeti Prokurori nëse të dy, i pandehuri i parë dhe i dyti ishin të pranishëm kur ajo punoi në kafene. Në përgjigjen e saj ajo deklaroi

*"Po, ata ishin të ulur në tavolinë së bashku, por pastaj Pali shkoi të bisedonte me klientët"*

Lidhur me të pandehurin e dytë Znj. deklaroi

*"E njoh Aleksander Pitaqin, ai ishte pronar i kafenesë "As," edhe në Gjakovë, unë punova për te për gjashtë muaj. Pas gjashtë muajve, gjatë se cilës kohë unë vazhdimisht punova për Aleksandrin, unë u transferova tek Pal Pitaqi.*

*Gjersa punova për Aleksandrin, unë asnjëherë nuk kam dalë me myshterinj."*

Prokuroria pranoi si dëshmi procesverbalin e marrjes në pyetje të të datës 17 Prill 2007 dhe 10 Maj 2007. Avokatet mbrojtës të të pandehurit të parë dhe të pandehurit të dytë ishin të pranishme në të dy dëgjimet dhe kanë parashtruar pyetje dëshmitares. Ajo po ashtu ka dhënë deklaratë në polici me datë 8 Prill 2007.

Me pëlqimin e Prokurorisë dhe avokateve mbrojtës dëshmia e saj paraprahe u pranua si dëshmi sipas Nenit 368 të Kodit të Procedurës Penale.

Ajo deklaroi se në Janar 2007 ajo foli me e cila i propozoi asaj të punonte si kamarriere tek i pandehuri i parë.

Ajo tha se para se të arrinte në Kosovë ajo kishte pranuar një kontratë me faks. Kushtet e kontratës ishin që ajo do të punonte si kamarriere dhe do të merrte pagë mujore prej 150 Eurosh. Ajo tha se ishte i pandehuri i parë i cili pagoi biletën e aeroplanit për te nga Moldavia për në Kosovë. Në deklaratën e saj të datës 10 Maj 2007 ajo deklaroi se ajo arriti në Kosovë me .

Aktakuza pohon se me datë 1 dhe 2 Shkurt 2007 i pandehuri i tretë beri dy transferime në vlerë totale prej 1200 Eurosh. Ishte shembulli i Prokurorit se këto shuma u transferuan "shumë pak kohë para se të fluturonte dhe nga Moldavia për në Kosovë". Në të vertet, sipas shënimeve policore për imigrim, hynë në Kosovë me datë 16 Janar 2007. Kur ajo dëshmoi me datë 10 Maj 2007 deklaroi se arriti në Kosovë Janar 2007. Në gjashtë muaj para ardhjes së në Kosovë e pandehura e tretë beri dy transferime<sup>5</sup> përmes Western Union tek në shumën totale prej 350 Eurosh.

Me të arritur në Kosovë ajo u takua në aeroport me të pandehurin e parë dhe u dërgua në një shtëpi në Gjakovë. Ajo filloi punën në "West Park" ditën tjetër. Ajo punonte nga ora 6 pasdite deri në mesnatë.

Ajo deklaroi<sup>6</sup> se pas një jave pune si kamarriere dhe valltare ajo filloi të kryente shërbime seksuale për klientët. Ajo tha se kreu shërbime seksuale për afro 20 klient. Gjate dëgjimit të saj me datë 17 Prill 2007 ajo tha se kishte pasur seks me rreth 10 dhe 15 klientëve.

Duke iu përgjigjur pyetjes së parashtruar nga avokati mbrojtës Znj. dëshmoi

<sup>5</sup> 10 Nëntor 2006 dhe 8 Janar 2007.

<sup>6</sup> Ekstrakt nga dëshmia e dëshmitares nga shqyrtimi i saj i dates 10 Maj 2007 ruajtur ashtu si tregohet

*"...po ta kisha ditur se do të bëja gjëra të tjera përpos punës së kamarrieres nuk do të vija në Kosovë."*

Ajo u pyet nga Prokuroria se a ka folur ndonjëherë me klientë. Duke u përgjigjur ajo dëshmoi

*"ne nuk flisnim me klientë sepse ne nuk dimë shqip dhe nuk na lejohej. Ishte gjithmonë Pali ai që fliste me ta dhe më pas na thoshte të bëheshim gati dhe të shkonim me ta."*

E pyetur nga Prokurori se a me dëshirë janë inkuadruar në ofrimin e shërbimeve seksuale klientëve, Znj. dëshmoi

*"Gjithmonë ishte pa dëshirën tonë. Ishte e domosdoshme jo pse pronari i "West Park-ut" Pal Pitaqi më urdhëronte, por sepse ai do thoshte "ose puno ose kthehu në vendin tënd". Edhe pse pa dëshirën time ishte gjithmonë për shkak të kushteve ekonomike që më [bënë] mua të futesha në shërbime seksuale".*

Si do që të jetë, kur u morë në pyetje me datë 17 Prill 2007 Znj. dëshmoi

*"Kur fillova të punoja si kamarriere, Pali më pyeti nëse, përpos punës si kamarriere, unë do të ofroja edhe shërbime seksuale për myshterinjtë e interesuar, dhe për këto shërbime ai më ofroi 50 përqind të çmimit të arritur. Unë vullnetarisht pranova, sepse ishte në interesin tim."*

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007 ajo tha

*"Pali i zgjidhte klientët gjithmonë"*

Ajo dëshmoi se nuk e ka pa të pandehurin e parë të merrte parat nga klientët. megjithatë, ajo deklaroi se ishte arritur marrëveshja se ajo do të merrte 50% të parave që i pandehuri i parë i mori për shërbimet seksuale që ajo ofroj. Ajo tha se nuk kishte marr asnjë para nga i pandehuri i parë.

Kur u dëgjua me Prill 2007 Znj. dëshmoi

*"Myshterinjtë gjithnjë përzgjidheshin nga Pali, ai gjente myshterinjtë dhe më pyeste "a pajtohesh me dalë"*

*me myshteriun," dhe unë pajtohesha, dhe pastaj Pali më dërgonte në hotel me veturë, dhe vinte të më merrte në mëngjes."*

Me datë 17 Prill 2007, në përgjigje të pyetjes nga avokati mbrojtës ajo deklaroi

*"kurdo here që shkoja me klientë të cilët i kishte zgjedhur Pali gjithmonë shkoja me dëshirë, sepse kështu ishte marrëveshja jonë paraprake, asnjëherë nuk kisha frikë nga Pali, sepse nuk kisha arsye të frikohesha sepse Pali gjithmonë më ka trajtuar mirë mua si dh vajzat e tjera."*

Ajo tha

*"mua dhe vajzave të tjera na jepnin para vetëm për cigare dhe pije, ndërsa ushqimin na siguronte pronari".*

Kur ajo deklaroi me datë 17 Prill 2007 ajo tha

*"Para se të filloja të punoja me Pal Pitaqaj ia kisha borxh 600 Euro, shpenzimet e udhëtimit nga Moldavia për në Kosovë dhe kur fillova të punoja për te unë gradualisht ia ktheja këtë borxh dhe tani Pali më ka borxh mua 395 Euros"*

Prokurori propozoi të futet në dëshmi "ditari i  
". Me keqardhje ky dokument nuk u gjet as në  
Prokurori e as në dosjet e Gjykatës.

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007, lidhur me lirin e saj të lëvizjes, ajo deklaroi

*"ne mund të dilnim në qytet por vetëm kur e pyesnim Palin dhe ai na lejonte"*

Lidhur me natën e 7 Prillit 2007 Znj. dëshmoi se të dy, i pandehuri i parë dhe i dytë ishin të pranishëm "West Park". Ajo tha se i pandehuri i parë po bisedonte me klientë. Ajo e përshkroi se si i pandehuri i parë e shoqëroi atë dhe tek Hoteli Metropol.

Me 17 Prill 2007 ajo deklaroi

*"...me datë 7.04.2007, Pali na tha se duhej të shkonim*

në hotel, sepse kishim dy klientë, dhe ne shkuam në veturë te hotel "Metropol" në Gjakovë. Ne menjëherë u nisem për tek dhomat në kat t<sup>7</sup> hotelit."

Znj. u pyet për të pandehurin e dytë

Prokurori "A vinte ndonjëherë Aleksander Pitaqi në kafene?"

Ms. : " Po, kohë pas kohe"

Prokurori: " A e ke pa ndonjëherë Aleksandrin duke folur me klientë apo duke marr para nga ata, apo të detyronte kamarrieret për të ndërmarr ndonjë gjë?"

Znj. : "Jo, unë asnjëherë nuk kam folur me te. Ne vetëm përshëndeteshim me njeri tjetrin, ai do rrinte aty por unë vete se kam pare që ka folur me klientë"

Prokurori: "A ka folur ai me vajzat për ty?"

Znj. : "jo, kurdoherë që vinte ai fliste vetëm me Palin. A pinte diçka dhe çdo herë ai e paguante vetë pijen"

Prokuroria vuri në dëshmi Procesverbalin e Marrjes në Pyetje të datës 2 Maj 2007 të Oficerit si dhe Procesverbalin e Dëshmisë së Oficerit para Gjykatës me datë 20 Maj 2008. Avokati i të pandehurit të parë dhe të dytë ishte i pranishëm në të dy shqyrtimet dhe ka i parashtruar pyetje dëshmitarit.

Oficeri dëshmoi në gjykimin e dytë të të pandehurve. Kur dëshmoi para Gjykatës kujtesa e tij për ngjarjet e Prillit 2007 ishte e paqartë. Kjo ishte pjesërisht për shkak të kalimit të kohës dhe sepse ai dëshmoi, dhe se qysh nga ajo date e këtyre ngjarjeve ka marr pjesë në shumë operacion të ngjashme<sup>7</sup>. Gjykata e pranoi se koha e kaluar në mënyrë të paevitueshme ka zbehur kualitetin e dëshmisë së tij. Veç kësaj, përfshirja e tij në operacione tjera të ngjashme sigurisht mund të rezultojë me përzierjen e ngjarjeve për ditën në fjalë me këto operacione të vazhdueshme. Oficeri qëndroi prapa dëshmisë së tij paraprake.

---

<sup>7</sup> Ai dëshmoi për 10 – 15 që nga 2007.

Kur u paraqit para Gjykatës në Maj 2008 ai thjeshtë zgjodhi të pranoi dëshminë që dha në Maj 2007.

Duke iu referuar transkriptit nga dëgjimi i oficerëve me 2 Maj 2007<sup>8</sup>, nuk përmendet në fillim të transkriptit për natën në fjalë kur ka dëshmuar oficeri. Megjithatë, Gjykata konkludon se ai i referohet ngjarjeve të 7 Prillit 2007. Gjykata po ashtu konkludon se Oficer ishte i shoqëruar nga Oficer . Që të ishin në rroba civile si pjesë e operacionit të fshehtë.

Oficerët ishin të pajisur me pajisje të fshehtë për incizim audio dhe video. Incizimet nga dvd-ja të bëra gjatë operacionit të fshehtë Prokuroria i ka futur në dëshmi.

Oficeri përshkroi që hyn në West Park rreth orës 10.40 minuta të mbrëmjes. Vajzat po 'luanin në shtizë'. Ata pyeten njëren nga kammarrieret nëse mund të flisnin me pronarin. Oficeri dëshmoi se i pandehuri i dytë iu afrua tavolines së tyre dhe hyri në bisedë me ta. Oficer deklaroi

*"Aleksandri na ofroi shërbime, ai pyeti se a donim një vajzë të rrinte me ne apo donim marrëdhënie seksuale"*

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai mendoi se ishte ai apo Oficer ai i cili filloi bisedën për vajzat lidhur me ofrimin e shërbimeve seksuale. Kjo ishte një mospërputhje me dëshminë e tij të paraprake. Megjithatë, Gjykata konkludon se dëshmia e tij e mëhershme është më e besueshme e dhënë më pas atë datë të ngjarjeve në fjalë.

Oficeri dëshmoi se ata kërkuan marrëdhënie seksuale. Lidhur me të pandehurin e dytë Oficer deklaroi

*"...ai u përgjigj se është 100 Euro për një femër nga ora 24.00 deri në ora 08.00..."*

Gjatë dëgjimit Oficeri u pyet nëse mund të identifikonte të pandehurin e dytë po ti tregoheshin fotografit. Si do që të jetë, nga procesverbali nuk është e qartë se në të vërtetë a iu treguan Oficerit fotografit dhe se a e identifikoi ai të pandehurin e dytë.

---

<sup>8</sup> Referenca ketu ka të bëjë me marrjen në pyetje të Oficereve me 2 Maj 2007 me perjashtim të rasteve kur është deklaruar ndryshe.

Oficeri dëshmoi se ia dhanë të pandehurit të dytë 200 Euro - 100 Euro për secilën vajzë. Ai tha se ia dha të pandehurit e dytë dy bankënota prej 50 Euro dhe Oficer ia dha të pandehurit e dytë një bankënotë prej 100 Euro.

Oficeri dëshmoi

*"...Aleksandri urdhëroi atë që ai të merrte femrat me veturën e tij për në motel, ai morri femrat dhe ne e përcollëm prapa me veturën tonë".*

Është e paqartë se kujt po i referohet Oficeri kur thotë se i pandehuri i dytë urdhëroi "atë".

Megjithatë, dëshmia e DVD-së në të cilën është mbështet Prokuroria gjithashtu përshkruan të pandehurin e parë. Ai mund të shihet në bisedë me të pandehurin e dytë.

Oficeri përshkroi hyrjen në Hotel Metropol dhe më pagimin e 40 Eurove recepsionistit për dy dhoma. Nuk ka mëdyshje se personi të cilit Oficer Osmani ia dha paratë ishte recepsionisti i Hotelit . Oficeri dëshmoi se personi që solli vajzat në Hotel u largua menjëherë. Është e qartë se ai nuk e kishte fjalën për të pandehurin e dytë.

Në deklaratën e datës 19 Prill 2007 deklaroi se ishte i pandehuri i parë ai të cilin ai e pa duke qëndruar jashtë Hotelit kur vajzat dhe Oficeri dhe arritën, duke sugjeruar se ishte i pandehuri i parë ai i cili i solli me veturë ata në Hotel.

Oficeri përshkroi të pandehurin e parë të kishte qenë prezent në West Park natën në fjalë. Ai tha se i pandehuri i parë hyri dhe u largua nga kafeneja dhe foli me myshterinj.

Kur dëshmoi para kësaj gjykate ai kishte kujtesë të dobët lidhur me ngjarjet pas largimit nga West Park.

Gjate dëshmimit të tij me 2 Maj 2007 Oficeri përshkroi negociatat e tija me të pandehurin e dytë dhe dhënien e parave të pandehurit të dytë si pagesë për shërbime seksuale.

Kur dëshmoi para Gjykatës me 20 Maj 2008 Oficer iu

referua bisedës së tij fillestare me të pandehurin e dytë. Megjithatë, ai pastaj dëshmoi

*"Besoi që më kujtohet personi që mi solli ato femra, ai person ishte Pali, ai ndërmjetësoi, parat ia dhashë Palit."*

Kështu që, kur ai dëshmoi me 20 Maj 2008 Oficeri ishte i sigurt se kishte negociuar me të pandehurin e parë dhe se parat ia kishte dhënë të pandehurit e parë. Kjo binte ndesh me dëshminë e tij të dhënë me 2 Maj 2007.

Por, gjatë vazhdës së gjyqimit me datë 20 Maj 2008 Oficer tregoj kah i pandehuri i dytë dhe, sipas procesverbalit, identifikoi të pandehurin e dytë si personin me të cilin diskutoj për shërbime seksuale që të siguroheshin nga vajzat.

Paksa e padobishme, kur identifikoi të pandehurin e dytë si personin me të cilin diskutoi shërbimet seksuale, procesverbali thotë

*"Kam folur me Palin vetëm atëherë kur e thirrrem atë përmes kamarrieres. Unë dhe Pali, ne bëmë bisedën"*

Është e qartë se oficeri ngatërron emrat e të pandehurit të parë dhe të dytë.

Kur dëshmoi para Gjykatës ai nuk ishte në gjendje të identifikonte në mes të pandehurve personin me të cilin ai tha se kishte negociuar me datë 7 Prill 2007. Gjykata konkludon se nuk është fare e çuditshme kur kihet parasysh kalimin e kohës si dhe personat e panumërt me të cilët dëshmitari kishte rënë në kontakt gjatë punës së tij.

Pas shikimit të dëshmive nga DVD-ja mbi të cilat Prokuroria u mbështet, Gjykata konkludon se ishte në të vërtetë i pandehuri i dytë me të cilin oficeret ishin në bisede. Kualiteti i zërit në këtë incizim është i dobët. Është e pamundur që qartë të dëgjohet përmbajtja e bisedës. Ne këtë rrethanë, Gjykata zgjedh të besoj dëshminë e oficerit lidhur me bisedën me të pandehurin e dytë.

Gjykata e konsideron Oficer si dëshmitar të saktë dhe të besueshëm.

Prokurori futi në dëshmi Procesverbalin e dëgjimit me datë 2 Maj 2007 të Oficer [ ] si dhe Procesverbalin e dëshmisë së Oficereve para Gjykatës me 20 Maj 2008. Mbrojtja e të pandehurit të parë dhe të dytë në të dy shqyrtimet ishin prezent dhe i parashtruan pyetje dëshmitarit.

Oficeri dëshmoi se në gjykimin e dytë të të pandehurve. Kur dëshmoi para kësaj Gjykate kujtimet për ngjarjet e Prillit 2007 ishin po ashtu të turbullta. Prapë, kjo ishte, pjesërisht, për shkak të kalimit të kohës sepse Oficeri që nga ajo datë e ngjarjeve në fjalë ka marr pjesë operacione të shumta të ngjashme<sup>9</sup>. Gjykata e pranon se kalimi i kohës në mënyrë të paevitueshme ka zbehur kualitetin e dëshmisë së tij. Oficeri qëndron prapa dëshmisë së tij paraprake.

Oficer [ ] dëshmoi me 2 Maj 2007<sup>10</sup> se në natën në fjalë ai shkoi në West Park, dhe arriti rreth orës 10.40 minuta të mbrëmjes. Gjykata konkludoi se ai ishte i shoqëruar me Oficer [ ]

Oficer [ ] tregoi të ketë biseduar me të pandehurin e dytë. Ai deklaroi

*"Pronari erdhi, ai u prezantua si Aleksander..."*

Oficer [ ] më pas u pyet nga mbrojtja e të pandehurit të dytë se a ishte i sigurt që i pandehuri i dytë ishte pronari i kafenesë. Në përgjigje Oficer [ ] dëshmoi

*"Po, ... ai e prezantoi veten si pronar me emër Aleksander"*

Kur dëshmoi me 2 Maj 2007 Oficer [ ] u pyet nëse mund të identifikonte të pandehurin e dytë në fotografi. Përsëri, ishte e paqartë nga Procesverbali nëse, në të vërtetë, iu treguan Oficerit fotografit dhe nëse ai identifikoi të pandehurin e dytë.

Kur ai dëshmoi para kësaj Gjykate ai nuk ishte në gjendje të identifikoi në mes të të pandehurve personin me të cilin ai tha se kishte folur me datë 7 Prill 2007. Prapë, Gjykata konkludon se kjo nuk është tërësisht për tu mos

<sup>9</sup> Ai dëshmoi 6 apo 7 çdo vit që nga 2007

<sup>10</sup> Referenca këtu ka të bëjë marrjen në pyetje të Oficerit me 2 Maj 2007 me perjashtim të rasteve nese ka deklaruar ndryshe.

befasuar kur dihet kalimi i kohës si dhe personat e panumërt me të cilët ai kishte rënë në kontakt gjate punës së tij.

Kur ai dëshmoi me 2 Maj 2007 Oficeri u pyet për bisedën e tyre me të pandehurin e dytë. Në përgjigje Oficer dëshmoi

*"Aleksandri na pyeti se a dëshironim të shërbeheshim në tavolinë apo dëshironim të kishim seks"*

Oficeri vazhdoi

*"pronari na njoftoi se për një kamarriere tarifa ishte 100 Euro"*

Oficeri dëshmoi se ata paguan paratë kur u larguan nga kafeneja. Të pandehurit të dytë ia kishin dhënë një bankënotë prej 100 Eurosh dhe dy bankënota prej 50 Eurosh për të dy vajzat. Ishte bërë e qartë nga biseda e Oficereve me të pandehurin e dytë se shërbimet seksuale do të ofroheshin në një tjetër lokal. Lidhur me të pandehurin e dytë Oficeri dëshmoi

*"...ai na tha, unë e kam punëtorin tim dhe ju përcilleni atë se në cilin motel ai shkon."*

Oficeri u pyet nëse mund të identifikonte personin që dërgoi vajzat në Hotelin Metropol në natën në fjalë. Si përgjigje Oficeri deklaroi *"Po, ky është ai personi të cilin ju më thatë ta shikoja. Është e paqarte se kujt po i referohej Oficeri. Si do që të jetë, më vonë në dëshminë e tij, Oficeri deklaroi*

*"Në hotel ku ne hymë bashkë me vajzat që ishin në veturë para nesh, femrat ishin me Pal Pitaqi"*

I pandehuri i dytë i quajtur . Ai tha se e kishte njohur të pandehurin e dytë për 10 - 15 vite. Ai ishte pronari i shkollës së vozitjes "EDI". Ai tha se në Prill 2005 ai bleu një kamion Mercedes nga i pandehuri i dytë. Ai tha se pagoi 5,000 Euro në dorë.

Mbrojtja e të pandehurit të dytë futi në dëshmi një kontratë origjinale të nënshkruar por të pavërtetuar të datës 2 Prill 2005, që dëshmon blerjen nga nga i

pandehuri i dytë të një Mercedes Benz tipi 817 makinë motorike me numër targash 480 - KS - 597. Çmimi kontraktues ishte 5,000 Euro. Dokumenti i regjistrimit si dhe certifikata e motorit si dhe leje qarkullimin lidhur me makinën në fjalë u futen si dëshmi gjithashtu.

Dëshmitari i dytë është i quajtur . Ai është kushëri i të pandehurit të dytë. Ai tha se në vitin 2005 ai bleu një automjet Audi A4 nga i pandehuri i dytë. Ai tha se pagoi 7,200 Euro para në dorë. Ai tha se ai e kishte pasur veturën për afro dy vite para se ai ta shiste atë. Ai nuk mban mend se a ishte vetura e regjistruar në emër të tij apo në emër të gruas së tij.

Mbrojtja e të pandehurit të dytë futi si dëshmi një kontratë origjinale të nënshkruar por të pavërtetuar të datës 12 Shtator 2005, që dëshmon blerjen nga Muse Doda nga i pandehuri i dytë të një Audi A4 me numër targash 409 - KS - 622. Çmimi kontraktues ishte 7,200 Euro.

I pandehuri i dytë thirri . Ai tha se e kishte njohur të pandehurin e dytë për disa vite. Ai tha se në vitin 2003 ai bleu një kamion Daimler Benz nga i pandehuri i dytë. Ai tha se kishte paguar me para në dorë. Ai nuk mban në mend se a pagoi 7,000 Marka Gjermane apo 3,000 - 4,000 Euro. Nuk pati asnjë kontratë për ta futur si dëshmi që do të dëshmonte këtë blerje të kësaj veture. Certifikata e regjistrimit u fut në dëshmi që vërtetonte se , djali i dëshmitarit, është mbajtësi i regjistruar aktual i kësaj veture.

Me mirëkuptim të palëve, mbrojtja e të pandehurit të dytë fut si dëshmi një kontratë origjinale të nënshkruar por të pavërtetuar të datës 22 Shkurt 2006, e cila kishte për qëllim të dëshmonte blerjen e nga i pandehuri i dytë të një makine Nisan Patrol me numër të targave 470 - KS - 016. Çmimi nga kontratat ishte 5,300 Euro. Ztr. Mehmeti u ftua që të paraqitet para kësaj Gjykate. Por, fletëthirrja nuk i ishte dorëzuar atij.

I **Pandehuri i Parë** është dëgjuar me 17 Maj dhe 27 Korrik 2007. Ai dëshmoi me 22 Maj 2008 në gjykimin e tij të parë. Ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 në gjykimin e tij të dytë.

Gjatë dëgjimit të tij në Maj 2007<sup>11</sup> ai vërtetoi se ishte pronar i Dardanisë dhe West Park. Kur u dëgjua me 27 Korrik 2007 ai tha se West Park-u ishte nën-degë e Dardanisë dhe se ishte formuar në vitin 2006.

I pandehuri i parë, si pronat i "Dardania P", deklaroi të hyrat për periudhat TM1/2005 dhe TM4/2005. Nuk u paraqit asnjë dëshmi në Gjykatë për ndonjë deklaram të tatimit të mëtejme që është bere.

Sipas dokumentit të regjistrimit të kompanisë veprimtaria kryesore e Dardania P ishte tregtia me automjete, mirëmbajtja dhe riparimi i veturave. Veprimtaria e dytë ishte tregtia me pjesë dhe vegla të veturave. Veprimtaritë e tjera ishin restorantet dhe klubet e natës

Tatimi është tërhequr nga burimi nga Nëntori i 2005 deri në Maj të 2006 dhe Pensionet nga Dhjetori i 2005 deri në Janar të 2006.

Për periudhën kohore 03/2005 - 12/2005 qarkullimi i deklaruar i Dardania P ishte 6,236 Euro.

Nuk kishte shënime tatimi të ndara për "West Park".

I pandehuri i parë tha se kishte punësuar shtatë vajza në West Park. Ai tha se ato ishin

" , , , , ( )".

Kur deklaroi me 22 Maj 2008 ai tha se nuk i kujtoheshin emrat e të gjitha vajzave të cilat punuan në kafene po tha se ato përfshiheshin nga

"...Veronika, , ,  
dhe ".

Gjykata konkludon se " " është .

I pandehuri i parë dëshmoi se vajzat ishin nga Moldavia dhe se përpara punonin për "Aleksandrin"<sup>12</sup>. I pandehuri i parë e sqaroi këtë duke thënë

"Quhej "AS", kompania ishte AS por është e njëjta

<sup>11</sup> Referenca ketu eshte per proceseverbalin e shqyrtimit të 17 Maj 2007 me perjashtim të rasteve nese eshte deklaruar nergut ndryshe.

<sup>12</sup> Gjykata konkludon se "Aleksander" i referohet të paditurit të dytë.

*kafene, që do të thotë se tash është West Park”.*

Kur ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i parë deklaroi se pronat dhe stafi i AS-it i barten tek West Park-u dhe West Park-u më pas u zhvendos në fshatin Lug Bunar.

I pandehuri i parë deklaroi se paga mujore sipas kontratës për secilën vajzë ishte 150 Euro. Ai tha se vajzat gjithashtu merrnin përqindje nga parat e pijeve që myshterinjtë konsumonin kur ato uleshin me myshterinj dhe i argëtonin ata.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i parë deklaroi se të gjitha vajzat kishin kontratë punësimi. Ai tha se secila vajzë mbante vetë dokumentet origjinale të identifikimit dhe se kishin liri lëvizjeje. Ai tha se pagat e tyre mujore paguheshin rregullisht.

Në përgjigjen e tij në pyetje lidhur me aranzhimet e udhëtimit për secilën vajzë i pandehuri i parë u përgjigj

*“unë ju dërgoja para për bileta, secilës që ka ardhur në kafenenë time, përmes Western Union-it dhe biletat ishin bileta për dy drejtime”*

Kur dëshmoi me 22 Maj 2008, duke iu referuar në veçanti i pandehuri i parë dëshmoi

*“...unë ia dërgova asaj paratë që të mund të vinte në Kosovë. I dërgova afro 600 Euro dhe atë për biletë kthyesë...i thashë se kur të vinte në Kosovë duke punuar për mua do mi kthente ato pak nga pak. Unë nuk e kam obliguar apo detyruar të atë që të dilte me ndonjë klientë”*

Kur ai dëshmoi me 22 Maj 2008 i pandehuri i parë mohoi se i kishte kërkuar të pandehurës së tretë që ti dërgonte para në emër të tij.

Lidhur me të pandehurin e dytë, i pandehuri i parë dëshmoi se i pandehuri i dytë e vizitonte shpesh West Park-un për shkak se dashnorja e tij, e pandehura e tretë, punonte aty. Ai mohoi se i pandehuri i dytë kishte ndonjë interes financiar në West Park.

Lidhur me ngjarjet e 7 Prillit 2007 ai tha se e hapi

kafenenë në ora 6 pasdite dhe pastaj u largua. Ai tha se e ëma e tij ishte e sëmurë. Ai tha se i la vajzat pa mbikëqyrje. Ai tha se u kthye në kafene në ora 10 të mbrëmjes. Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se u kthye në kafene pas orës 11 të mbrëmjes.

Ai tha se kur u kthye në kafene i pandehuri i dytë dhe e pandehura e tretë po rrinin së bashku.

Kur dha dëshmi me 17 Maj 2007 i pandehuri i parë deklaroi se pas punës dy nga vajzat "e luten" atë që ti dërgonte ato në Hotel Metropol. Ai i dërgoi ato te hoteli, zbriti nga vetura dhe i përcolli të dy vajzat deri tek dera e hotelit. Ai dha dëshmi të njëjtë me 22 Maj 2008. Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se dy vajzat që ai i dërgoi në hotel ishin dhe . Si do që të jetë, dëshmia e tij para kësaj Gjykate e kundërshton dëshminë e tij paraprake. Kur ai dëshmoi para Gjykatës ai tha se nuk kishte hyr në parking të veturave të këtij hoteli. Ai tha se u ndal në rrugë dhe se dy vajzat zbriten. Ai tha se nuk kishte dalë nga vetura.

I pandehuri i parë mohoi se kishte pyetur ndonjëherë vajzat se a do të ishin të gatshme të kryenin marrëdhënie seksuale me myshterinjtë. Ai përshkroi vajzat të kishin liri të zgjidhnin se si të visheshin, se atë vallëzonin për myshterinjtë dhe kishin liri lëvizjeje.

I **pandehuri i dytë** u dëgjua me 17 Maj dhe 27 Korrik 2007. Ai dëshmoi me 23 Maj 2008 në gjykimin e tij të parë<sup>13</sup>. Ai dëshmoi para kësaj Gjykate me 22 Shkurt 2011.

I pandehuri i dytë deklaroi se ai ishte pronar i AS-it. Ai tha se ai e mbajti kafenenë për 5 - 6 muaj. Ai tha se mban mend se kishte punësuar 5 vajza.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri dytë tha se pati një aksident me 13 Mars 2006. Ai dëshmoi se nga ajo datë deri sa As-i pushoj së vepruari deri në fund të vitit 2006 kafenenë e mbajti shoku i tij i quajtur " ". Ai dukej i pasigurt për emrin e familjes së . Ai tha se mendonte të ishte . Ishte paksa e çuditshme që i pandehuri i dytë të ja besonte dikujt të ja mbante biznesin

---

<sup>13</sup> Referenca ketu është nga Procesverbali i shqyrtimit të 17 Maj 2007 me përjashtim të rasteve nese është deklaruar nergut ndryshe

për emrin e të cilit ai duket se nuk është i sigurt.

Mbrojtja e të pandehurit të dytë vuri si dëshmi vërtetimin e Lëshimit të lëshuar nga Klinika Ortopedike të Prishtinës që vërteton se i pandehuri i dytë kishte qenë pacient atje gjate periudhës kohore 13 - 17 Mars 2006 pas një aksident të trafikut rrugor me 13 Mars 2006 kur, me sa duket, i pandehuri i dytë pësoi lëndime në shpinë.

I pandehuri i dytë dëshmoi me 22 Shkurt 2011 se që nga viti 2000/2001 ai ishte marr me biznes të shitjes së veturave. Ai tha se shiti diku prej 5 deri në 10 vetura në vit. Ai mendon se fitimi i tij në shitjen e secilës veturë ishte në rajon prej 200 - 800 Euro. Ai tha se biznesi nuk ishte i regjistruar për shkak të tatimit.

Përveç shitjes së veturave ai po ashtu shiste edhe fruta dhe perime në tregun e vendit. As ky biznes nuk ishte regjistruar për shkak të tatimit.

Kur ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se të ardhurat e tij në vitin 2006 rridhnin nga "AS-i", shitja e veturave si dhe tezga në treg. Në vitin 2007, të ardhurat e tij të vetme ishin nga shitja e veturave si dhe tezga në treg.

I pandehuri i dytë, si pronar i kafenesë "AS" deklaroi të ardhurat për periudhën TM4<sup>14</sup>/2005 dhe TM1/2006. Tatimi është tërhequr nga burimi nga Nëntori i 2005 deri në Maj 2006 dhe Pensionet<sup>15</sup> nga Dhjetori 2005 deri në Janar 2006. Asnjë dëshmi nuk është paraqitur para Gjykatës se është bërë ndonjë deklaram i më mëtejme i tatimit.

Sipas dokumentit për regjistrim të kompanisë veprimtaria kryesore e AS-it ishte "restorant". Veprimtaria e dytë ishte "hotele dhe motele pa restorant". Veprimtaritë e tjera të tija ishin "hotele dhe motel me restorant".

Për periudhën 03/2006 qarkullimi i deklaruar i "AS-it" ishte 1,132 Euro.

Kur dëshmoi me 17 Maj 2007, lidhur me "AS-in" i tha se punësoi " " dhe " ". I pandehuri i parë dëshmoi

*"...unë pagova biletat e udhëtimit"*

---

<sup>14</sup> Periudha tre mujore/çerek

<sup>15</sup> Mbase fondi pensional

Por, kur dëshmoi me 23 Maj 2008 ai tha

*"...Më kujtohet se mbiemri i ishte ...Ato vetë paguan udhëtimin e tyre. Unë nuk e dija se si kishin mundësi."*

Kjo kundërshtonte dëshminë e tij paraprake.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai nuk mbante mend se a kishte paguar ai biletat e aeroplanit.

Me 23 Maj 2008 ai më tej dëshmoi

*"Unë nuk kam dërguar asnjë para këtyre femrave në Moldavi. Këto femra po punonin në një tjetër kompani në Kosovë, unë shkova atje, kam pirë disa pije dhe kam rënë në kontakt me to. Këto femra ishin Veronika Dragan dhe mua nuk më kujtohet "*

Lidhur me ngjarjet e 7 Prillit 2007 ai dëshmoi

*"Unë arrita në kafene rreth orës 21.30 minuta, kur hyra në kafene Pali ishte i ulur dhe unë vetëm e përshëndeta"*

Kjo e kundërshton dëshminë e të pandehurit të parë. Kur ai dëshmoi me 17 Maj 2008 i pandehuri i parë tha se ai nuk është kthyer në kafene deri në orën 10 të mbrëmjes dhe se me tu kthyer ai pa të pandehurin e dytë dhe të tretë të ulur bashkë. Kur i pandehuri i parë dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se nuk u kthye në West Park deri pas orës 11 të mbrëmjes. Ai tha se i pandehuri i dytë dhe i tretë ishin në kafene.

I pandehuri i dytë dëshmoi me 17 Maj 2007 se u largua nga kafeneja me të pandehurën e tretë në ora 10 të mbrëmjes.

Kur ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se arriti në West Park rreth orës 9.15 minuta të mbrëmjes. Ai tha se bisedoi me të pandehurën e tretë dhe i tha se nuk mund të dilte me te. Ai tha se i tha asaj "mirë u pafshim" dhe u largua. Në përgjigje të pyetjes së parashtuar se sa ai qëndroi në West Park ai tha "aq sa piva një shishe me ujë". Megjithatë kjo kundërshton dëshminë e të pandehurit të parë i cili tha se i pandehuri i dytë ishte në West Park kur ai u kthye në ora 11 të mbrëmjes.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë mohoi se kishte folur me ndonjë klientë në West Park atë mbrëmje. Kjo ishte gënjeshtër. Ai mund të shihet qartë në incizim e fshehtë duke folur me oficeret e fshehtë.

Kur dëshmoi me 17 Maj 2008 i pandehuri i dytë mohoi se kishte biseduar me Oficeret dhe lidhur me provizion për vajzat për shërbime seksuale.

Kur dëshmoi me 23 Maj 2008 i pandehuri dytë mohoi se vajzat e punësuar tek ai kishin kufizim të lëvizjes.

Kur ai dëshmoi me 23 Maj 2008 i pandehuri i dytë pranoi se kishte dërguar para marrësve të ndryshëm në Moldavi. Në përgjigje të pyetjes së parashtuar nga avokati i tij ai tha se ai dhe e pandehura e tretë po planifikonin të jetonin së bashku në Moldavi.

Mbrojtja e të pandehurit të dytë futi në dëshmi dokumentin e Western Union të datës 22 Nëntor 2006 duke iu referuar transferimit të parave prej 50000 Euro te i pandehuri i dytë.

Prokuroria futi në dëshmi përmbledhjen e xhirollogarisë së Kasabankes të pandehurit të dytë. Gjatë periudhës Dhjetor 2006 - Prill 2007 aktiviteti i përgjithshëm në atë xhirollogari ishte afërsisht 38,000 Euro. Tre deponime kapitale janë bërë: 15,000 Euros në Dhjetor 2006; 10,000 Euro në Mars 2007 dhe 13,000 Euro në Prill 2007.

Lidhur me deponimin e 15,000 Eurove në Dhjetor 2006 shënimi në deklaratën e Kasabankes thotë "deponim për blerje të shtëpisë dhe tokës- Aleksander Pitaqi".

Lidhur me deponimin e 10,000 Eurove në Mars 2007 shënimi i deklaratës thotë "Deponim Aleksander Pitaqi". Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha parat ishin të nënës së tij.

Lidhur me deponimin e 13,000 Eurove në Prill 2007 shënimi i deklaratës së Kasabankes thotë "Deponim i avokatit të ( ) për Aleksander Pitaqi për shitblerjen e shtëpisë dhe tokës".

Lidhur me xhirollogarinë e Kasabankes i pandehuri i dytë dëshmoi se me 23 Maj 2008 përmes Western Union ai pranoi shumën prej 5000 Euros nga kunati i tij. Raportet Unionit

të Financave i referohen një transferi prej 5000 Euro nga një dërgues nga Gjermania në Nëntor të 2006.

Janë tri tërheqje kapitale nga xhirollogaria: 15,000 Euro me 6 Dhjetor 2006; 1,000 Euro me 28 Mars 2007; 1,000 Euro me 30 Mars 2007; 1,000 Euro me 31 Mars 2007 dhe 20,000 Euro me 30 Prill 2007.

Lidhur me tërheqjen e 15,000 Eurove në 6 Dhjetor 2006 një shënim i deklaratës së Kasabankes thotë "transferimi i mjeteve në emër të patundshmërisë së shitblerjes-shitës , blerës Aleksander Pitaqi, komuna e Gjakovës, rruga. M. ".

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Eurove me 28 Mars 2007 një shënim i deklaratës së Kasabankes thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Eurove me 30 Mars 2007 një shënim i deklaratës së Kasabankes thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Eurove me 31 Mars 2007 një shënim i deklaratës së Kasabankes thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 20,000 Eurove me 30 Prill 2007 një shënim i deklaratës së Kasabankes thotë "Transferim i mjeteve në emër shitblerjes së patundshmërisë, parcela no.1247/1, shtëpi dhe oborr në sipërfaqe 0.01045 ha, komuna e Gjakovës."

Kur ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se pranoi shuma shtesë të gatshme nga dhëndri/kunati i tij në Gjermani. Ai tha se disa nga paratë ishin dërguar përmes nënës së tij. Ai nuk mban mend shumat që ka marrë.

Aktakuza vë në pah në mënyrë të veçantë se gjatë periudhës kohore 30 Janar 2007 - 3 Prill 2007 e pandehura e tretë transferoi përmes Western Union-it te marres të ndryshëm në Moldavi fonde që ajo ka pranuar nga i pandehuri i dytë. Provat mbi të cilat Prokuroria mbështetet treguan se lidhur me secilin transferim, i pandehuri i dytë dërgonte një SMS mesazh tek marrësi në Moldavi me numër të transferim dhe në disa raste, shumen e transferimit.

Kur ai dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë

deklaroi se i kishte dhënë të pandehurës së katërt për afërsisht 3000 Euro për të transferuar në Moldavi në emër të tij.

Sipas shënimeve të Unionit Financiar, gjatë periudhës Shkurt - Nëntor 2006 i pandehuri i dytë personalisht transferoi përmes Western Union-it shumën totale prej 4,800 Eurosh në Moldavi. Nga kjo shumë, 4750 Euro u derguan tek e pandehura e tretë.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë tha se ai dhe e pandehura e tretë po planifikonin të blinin një Moldavi. Ai tha se deri më këtë datë paratë nuk janë investuar në Moldavi.

**E Pandehura e Tretë** dha deklaratë në polici me datë 3 Maj 2007 dhe një deklaratë më pas me 11 Shtator 2007. Ajo u dëgjua nga Prokurori Special me 1 Tetor 2007<sup>16</sup>. Ajo dëshmoi me 23 Maj 2008 në gjykimin e saj të parë<sup>17</sup>. Ajo dëshmoi para kësaj Gjykate me 22 Shkurt 2011.

Gjatë kësaj periudhe 20 Shtator 2005 - 20 Mars 2006 ajo ishte e punësuar nga si valltare te "A&A". Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo kishte të drejtë sipas kontratës në ngritje prej 20% kur punonte jashtë orarit të punës dhe gjatë vikendeve. Duket se kontrata i ishte ndërprerë më herët.

Gjatë periudhës 17 Tetor 2005 - 17 Tetor 2006 ajo u punësua nga si valltare në "Lugano". Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo me kontratë kishte të drejtë për ngritje të 20% kur punonte jashtë orarit të punës dhe vikendeve. Duket se kontrata i ishte ndërprerë më herët.

Gjatë periudhës kohore 4 Nëntor 2005 - 4 Shkurt 2006 ajo u punësua te i pandehuri i dytë si kamarriere në "AS Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo me kontratë kishte të drejtë për ngritje të 20% kur punonte jashtë orarit të punës dhe vikendeve.

Gjatë periudhës kohore 6 Shkurt - 6 Maj 2006 e Pandehura e Tretë u punësua te i pandehuri i dytë si kamarriere në

---

<sup>16</sup> Referenca ketu është nga Procesverbali i shqyrtimit të datës 1 Tetor 2007 me përjashtim të rasteve nëse është deklaruar nergut ndryshe

<sup>17</sup> Referenca ketu është nga Procesverbali i shqyrtimit të 17 Maj 2007 me përjashtim të rasteve nëse është deklaruar nergut ndryshe

"AS". Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo me kontratë kishte të drejtë për ngritje të 20% kur punonte jashtë orarit të punës dhe vikendeve.

Gjatë periudhës kohore 1 Shtator 2007 - 1 Shtator 2008 u punësua të si valltare në restorantin Malibu. Paga e saj mujore ishte 200 Euros plus 2 Euro për çdo pije të shërbyer.

E pandehura e tretë dëshmoi se ajo ishte motivuar për shkaqe financiare të punonte në Kosovë. Ajo tha se arriti në Kosovë në Shtator 2005. Ajo tha se huazoj paratë për të paguar shpenzimet e udhëtimit. Ajo tha se u kthye në Moldavi për afërsisht pas dy muajve. Ajo më pas u kthye në Kosovë. Ajo dëshmoi se përveç udhëtimit të saj të parë për në Kosovë në Shtator 2005 të gjitha udhëtimet e më pasme janë paguar me para të saja.

Ajo tha se ka marr kontratë nga i pandehuri i dytë me faks gjersa ishte në Moldavi. Ajo dëshmoi se paga e saj mujore ishte 150 - 200 Euro. Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 e pandehura e tretë deklaroi se paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo me kontratë kishte të drejtë rritjeje të 20% kur punonte pas orarit të punës dhe në vikend e që mund të llogaritej se ajo të merrte deri në 200 Euro për muaj. Veç kësaj ajo merrte 20% për çdo pije të shërbyer dhe më pas 10% për secilën pije të blerë për te nga myshteriu të cilin ajo e argëtonte në tavolinë.

Ajo deklaroi me 23 Maj 2008 se, përveç pagës së saj mujore, ajo merrte para nga "pronari i kafenesë" si dhe merrte për afërsisht 60 Euro bakshish në natë nga myshterinjtë. Ajo më herët dëshmoi se ajo mund të fitonte 60 - 100 Euro gjatë ditës. Kur ajo dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ajo tha se merrte 60 - 70 Euros për natë. Ajo tha se nuk vallëzonte për myshterinj.

Ajo dëshmoi se ishte në marrëdhënie me të pandehurin e dytë dhe se ishte qëllimi i tyre për të "investuar bashkërisht".

Faturat e transferimeve të Western Union-it tregojnë se gjatë periudhës Shtator - Dhjetor 2005 e pandehura e tretë transferoi shumën totale prej 1,130 Euros te marres të ndryshëm në Moldavia. Sipas shënimeve të Unionit Financiar, gjatë periudhës kohore Mars 2006 - Mars 2007 e pandehura e tretë transferoi shumën totale prej 19,629 Euro në Moldavia.

Gjatë periudhës kohore Shkurt - Nëntor 2006 e pandehura e tratë pranoi përmes transferimit të parave shumen prej 4,750 Euro nga i pandehuri i dytë.

Gjatë periudhës Maj - Shtator 2006 e pandehura e tretë pranoi para në Moldavia transfero të parave të gatshme në shumë prej 3,700 Euro nga e pandehura e katërt.

Gjate periudhës Maj - Shtator 2006 e pandehura e tretë pranoi në Moldavi transferimin e parave në shumë prej 4,000 Eurove nga

E pandehura e tretë u pyet lidhur me transferimin e parave që ajo krey tek marrës në Moldavi si dhe për paratë që kishte pranuar. Ajo dha sqarime të ndryshme lidhur me qëllimet e menduara të parave. Ajo po ashtu iu referua parave që ajo tha se kishte marr nga i pandehuri i dytë. Ajo dëshmoi "*unë kisha pagë dhe një të dashur që po më ndihmonte*".

Kur dëshmoi me datë 22 Shkurt 2011 ajo u pyet lidhur me origjinën e parave që ajo i mori nga i pandehuri i dytë. Në përgjigje ajo tha se ai punonte në treg. Ajo tha se ai po ashtu kishte të ardhura nga shitja e veturave.

Mbrojtja e të pandehurës së tretë futi në dëshmi përkthimin e një ekstrakti nga Raporti i Këshilltarit të Mjekësisë konsultative dhe Institucionit Sanitar të Qendrës së Mjekeve Familjar të Republikës së Moldavisë së datës 19 Shkurt 2009 ku vërtetohej se e ëma e të pandehurës së tretë ishte diagnostifikuar me hepatit kronik. E pandehura e tretë qëndroi prapa raportit të dytë të datës 22 Shkurt 2011. Ishte rasti i të pandehurës së tretë kur parat e transferuara në Moldavi ishin për të trajtimin e së ëmës së saj në spital.

E **Pandehura e Katërt** u dëgjua nga Prokurori Special me datë 25 Tetor 2007<sup>18</sup>. Ajo dëshmoi me 23 Maj 2008 në gjykimin e saj të parë<sup>19</sup>. Ajo dëshmoi para kësaj gjykate me 22 Shkurt

---

<sup>18</sup> Referenca ketu ka të bëjë me Procesverbalin e Shqyrtimit të dates 25 Tetor 2007 me perjashtim të rasteve nese eshte deklaruar nergut ndryshe

<sup>19</sup> Referenca ketu ka të bëjë me Procesverbalin e Shqyrtimit të dates 17 Maj 2007 me perjashtim të rasteve nese eshte deklaruar nergut ndryshe

2011.

E pandehura e katërt dëshmoi se arriti në Kosovë me datë 4 Shkurt 2006. Ajo tha se u takua në aeroport me të pandehurin e dytë dhe të pandehurën e tretë. Ajo dëshmoi se huazoi para nga një shok për të paguar shpenzimet e udhëtimit.

Ajo tha se punoi si kamarriere dhe valltare te kafeneja e të pandehurit të dytë, "AS", me katër vajza të tjera. Ajo tha se pranoi një kontratë përmes faksit në Moldavi. Ajo tha se paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo tha se merrte bakshish nga klientët. Ajo tha ndodhte të fitonte 30 - 40 Euro gjatë një nate. Ajo punoi në "AS" për 6 - 7 muaj.

Gjatë periudhës kohore 8 Shtator 2006 - 8 Mars 2007 ajo ishte e punësuar nga i pandehuri i parë si valltare në "West Park". Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo kishte të drejtë me kontratë ngritje prej 20% për pune jashtë orarit si dhe në vikende.

E pandehura e katërt sqaroi se vendimi i saj që të punonte si kamarriere në Kosovë ishte komercial. Ajo tha se kamarrieret në Kosovë fitojnë më shumë se sa kamarrieret në Moldavi. Ajo tha se ajo transferoi përmes Western Union-it para nga Kosova tek e motra e saj në Moldavi. Ajo tha se e motra e saj po kujdesej për vajzën e saj. Ajo më pas deklaroi se parat e dërguara tek e pandehura e tretë ishin për motrën e saj apo për babanë e saj. Disa transferime po ashtu ishin për të vëllain e saj. Ajo tha se i dashuri i saj ia kishte dhënë disa para.

Gjatë periudhës kohore Shkurt 2006 - Janar 2007 e pandehura e katërt transferoi përmes Western Union-it tek marres të ndryshme shumen totale prej 6,320 Euro.

Gjatë periudhës kohore Qershor 2006 - Shkurt 2007 e pandehura e katërt morri në Moldavi transfero të parave të gatshme në shumen prej 1,100 Euro nga e pandehura e tretë.

Gjatë periudhës kohore Mars - Maj 2007 e pandehura e katërt morri në Moldavi para të transferuara në shumen prej 880 Eurosh nga

Në Mars 2007 e pandehura e katërt mori në Moldavi transferimin e parave në shumë prej 650 Euros nga

E pandehura e katërt u pyet lidhur me transferimin nga ana e pandehura e tretë në shume prej 650 Eurosh në Qershor 2006. Ajo tha se kjo ishte që ti paguante asaj shpenzimet e udhëtimit. Ajo tha se kjo ishte hua.

Sikur e pandehura e tretë, edhe e pandehura e katërt dha sqarime të ndryshme lidhur me qëllimet e parave.

E pandehura e katërt bëri transferime për në Moldavi gjatë periudhës kohore Prill - Tetor 2006. Ajo filloj punën në West Park në apr 08 Shtator 2006.

Ajo dëshmoi se ajo po ashtu punoi si valltare në West Park për 5 - 6 muaj. Ajo tha se i pandehuri i parë ishte pronar i kafenesë. Ajo tha se i pandehuri i dytë vinte shpesh në West Park. Ajo tha se ai nuk punonte aty.

Ajo mohoi se ishte detyruar që jepte shërbime seksuale për klientë. Ajo tha se vetë e mbante pasaportën e saj dhe se kishte liri të lëvizjes. Ajo e kualifikoi këtë duke thënë se ajo ia dërgonte një mesazh të pandehurit të dytë kur dilte.

### **C. Vlerësimi i provave/dëshmive**

#### **i. Gjetja e faktit**

Gjykata konkludon se gjatë gjithë kohëve të rëndësishme i pandehuri i parë ishte pronar i regjistruar i West Park. West Park ishte emër tregtar i Kompanisë së biznesit Dardania P Sh.p.k. e cila ishte inkorporuar me 13 Tetor 2004 dhe regjistruar me 9 Nëntor 2004. Adresa e biznesit ishte Pashko Vasa numër 47, Gjakovë<sup>20</sup>.

Gjykata konkludon se gjatë gjithë kohëve të rëndësishme, i pandehuri i dytë ishte pronar i regjistruar i AS-it. Emri i biznesit ishte Ndërmarrje Hoteliere AS. Data e inkorporimit ishte 2 Nëntor 2005. Adresa e regjistruar ishte Mbretëresha , Gjakovë<sup>21</sup>. Pasi që pushoi së tregtuari në fund të vitit 2006 stafi i tij u transferua tek West Park.

<sup>20</sup> Numri i Certifikates së Regjistrimit 70204332 i dates 9 Nëntor 2004;

<sup>21</sup> Numri i Certifikates së Regjistrimit 70313657 i dates 2 Nëntor 2005

Gjykata konkludon se me datë apo rreth datës Shkurt 2007 West Park u zhvendos nga Gjakova në fshatin Lug Bunar në lokalitetin brenda 350 metrash të shkollës fillore Ahmet Rrustemi.

Gjykata konkludon se hyri në Kosovë me 13 Tetor 2006 dhe se asaj iu lejua të qëndronte deri me 4 Maj 2007; hyri në Kosovë me 16 Janar 2007 dhe iu dha leja të qëndronte deri me 11 Janar 2008.

Nuk ka dyshim se gjatë gjithë kohës së rëndësishme, numri i telefonit të të pandehurit të dytë ishte 044.

Asnjë nga palët e dëmtuara nuk ishte nën moshën 18 vjeç.

#### **ii. Cilësimi Ligjor e secilës Akuzë dhe vlerësimi i dëshmive**

Akuza 1 - Trafikim i Rëndë i Personave në bashkë-kryerje sipas Nenit 139 (1) dhe (3) dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Kundër të Pandehurit të Parë, të Dytë, të Tretë dhe të katërt.

Sipas Nenit 139 të KPPK-së termi "trafikim i personave" nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim apo pranimit të personave me mjete kërcënuese apo përdorim të forcës apo forma të tjera detyrimi, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo pozitës apo një pozite të ndjeshme apo duke marr ose dhënë pagesa apo përfitime për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.

Termi "eksplotim" siç përdoret në nënparagrafin 1 të paragrafit në fjalë përfshin, por nuk është i kufizuar me, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve apo formave të tjera të shfrytëzimit seksual, punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërisë apo praktikave të ngjashme me skllavërinë, robërisë apo heqjes së organeve.

Neni 139 (3) siguron se kushdo që organizon një grup të personave për të kryer një vepër do të dënohet me gjobë deri në 500.000 EURO dhe me burgim prej shtatë deri në

njëzet vite. Nuk është dhënë asnjë definicion për "grupin". Neni 109 i KPK-së i referohet një grupi që përbehet prej "më shumë se sa dy persona".

Pajtimi i viktimës së trafikimit të personave me shfrytëzim të qëllimshëm është, për shumicën e shkaqeve, jo relevant.

Sipas Nenit 23 kur dy apo më shumë persona kryejnë bashkërisht një vepër penale duke marr pjesë në kryerje të veprës penale apo duke kontribuar në kryerjen e saj në çfarëdo mënyrë, secili nga ta do të jetë përgjegjës dhe do të dënohet siç përshkruhet për këtë vepër penale.

### **1. I Pandehuri i Parë**

dëshmoi se asaj ia kishte mbushur mendjen që të punonte në Kosovë. Ajo tha se ia kishte lexuar kushtet e kontratës asaj. Atë e kishin pritur në Aeroportin e Prishtines i pandehuri i parë dhe e pandehura e tretë. Ajo tha se udhëtoi në Kosovë me biletë të cilën vetë e kishte blerë me para të "veta". Ajo tha se me të arritur në Kosovë ajo nënshkroi kontratën me të pandehurin e parë.

Ajo tha se ishte punësuar si kamarriere në West Park. Ajo tha se punoi atje për afro një javë. Ajo tha se kishte liri të lëvizjes. Ajo mohoi se e kishte detyruar i pandehuri i parë që të ketë marrëdhënie seksuale me klientë. Nuk pati dëshmi për shfrytëzim seksual apo, në të vërtetë, çfarëdo shfrytëzimi të nga ana e të pandehurit të parë apo të pandehurve të tjerë

dëshmoi se asaj ia kishte mbushur mendjen që të vinte dhe punonte si kamarriere në Kosovë. Ajo punoi në Kosovë në dy raste të ndryshme.

Në rastin/herën e parë duket se ajo udhëtoi në Kosovë me dhe në aeroport takoi të pandehurin e dytë. Ajo tha se huazoi paratë nga motra e saj për të blerë biletën. Ajo punoi për të pandehurin e dytë si kamarriere në AS për afro gjashtë muaj. Gjatë asaj kohe ajo mohoi që i pandehuri i dytë të kishte kërkuar nga ajo që të siguronte shërbime seksuale për klientët.

Ajo u kthye në Kosovë në Tetor të vitit 2006. Ajo fillimisht punoi për të pandehurin e dytë në AS. Ajo

deklaroi

*"Pas disa ditësh Aleksandri ndërroi biznesin dhe pronar ishte Pal Pitaqi. Kafeneja u emërua "West Park".*

Në të vërtetë, kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i parë deklaroi

*"quhej "AS", kompania ishte AS por është e njëjta kafene, që do të thotë tani është West Park".*

Ajo filloi të punoi në West Park ditën e nesërme. Ajo u punësua si kamarriere.

Përgjigjen në pyetjen e Prokurorit lidhur me atë se a është kërkuar ndonjë tjetër shërbim nga ajo që të kryej, lidhur me të pandehurin e parë, Znj. dëshmoi

*"Ai më tha nëse ti nuk kryen shërbime të tjera, do të shkosh në shtëpi. Kamarrierja duhej të kryente shërbime të tjera të ofruara nga pronari i kafenesë West Park"*

...

*"Ai më tha: "ti duhesh të punosh përndryshe të kthejmë në shtëpi"<sup>22</sup>*

Ajo dëshmoi

*"...Pal shkonte dhe bisedonte me klientë të ndryshëm që ishin të ulur në tavolina dhe pasi që merreshin vesh ai më thoshte të vishesha dhe të shkoja me ta"<sup>23</sup>*

Ajo tha se paguhej ekstra për të kryer këto shërbime.

*"Për secilën lidhje seksuale që ke, Pal më tha, ti do të marrësh 50 Euro dhe unë do të marr 50 Euro si pronar i kafenesë"*

Kur ajo dëshmoi me 17 Prill 2007 ajo tha

*"kur unë arrita në Kosovë, pronari i kafenesë Pal*

---

<sup>22</sup> Deklarata e dhene ne zyren e Prokurorit me 10 Maj 2007, faqe 3 te versionit Anglisht

<sup>23</sup> Deklarata e dhene ne zyren e Prokurorit me 10 Maj 2007, faqe 5 te versionit Anglisht

*Pitaqi më pyeti nëse, përpos punës sime të rregullore si kamarriere do të beja punë të tjera - prostitucion, unë e pranova këtë propozim dhe kështu fillova të merresha me prostitucion përpos punës sime si kamarriere."*

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007

*Prokurori: "Kur ti arrite në Kosovë a e ke ditë se Pali do të ju pyeste të përfshiheshit në prostitucion?"*

*: "Jo nuk e dija sepse ai më pat premtua se unë do të punoja si kamarriere..."*

Ajo dëshmoi se kishte pasur marrëdhënie me afro 15 klientë të West Park-ut.

Punëtoret femra të West Park u intervistuan nga policia me 23 Janar 2007 dhe 12 Shkurt 2007. Duket se intervistimet janë kryer në lokalet e West Park-ut. Kur dihet ky fakt, nuk është e çuditshme se dëshmitaret ishin më pak të sigjerta.

Me 10 Maj 2007 kur u pyet për lirin e lëvizjes, Znj. dëshmoi:

*"Gjatë kohës së tyre të lirë kur ishin në shtëpi, viktimat nuk guxonin të dilnin pa kontaktuar pronarin e kafenesë Pal Pitaqi dhe pa marr lejen e tij"*

Ajo më vonë e kualifikoi këtë gjë duke thënë se kjo ishte për "shkqej sigurie".

Në pyetje e avokatit mbrojtës Znj. dëshmoi

*"ne ishim të lira; dilnim dhe shkonim për kafe në restorante"*

Kur u dëgjua me 17 Prill 2007 Znj. deklaroi

*"...gjatë ditës, e kjo është, deri në ora 18:00, ne ishim të lira, ne shëtisnim neper qytet dhe askush nuk na ndalonte që të dilnim nga kafeneja."*

Duke iu referuar ngjarjeve të 7 Prillit 2007 Znj.

dëshmoi:

*"...atë natë Pali erdhi tek ne në kafene dhe na tha që të visheshim. Ne u veshëm, morëm xhaketat dhe ai na tha të shkonim dhe të uleshim në veturë. Ne shkuam me veturë në drejtim të Hotelit Metropol në Gjakovë.*

Kur u pyet nga Prokurori se kush bisedoi me klientët në tavoline Znj.           dëshmoi

*"Pali ishte ai i cili niste dhe arrinte marrëveshje. Aleksandri hyri, u ul dhe më pas u largua, ndërsa Pali ishte ai që na dërgoi në hotel"*

...

*"ne ishim të paret që arritëm tek hyrja e hotelit me Palin. Pastaj Pali u largua me veturë, dhe atëherë arritën klientët dhe ne me ta shkuam lart"*

Ajo dëshmoi se nuk e pa të pandehurin e parë që mori far pagese.

Znj.           u pyet nga prokurori nëse i pandehuri i parë ose i dytë kishte kërkuar nga ajo që të kryente ndonjë shërbim tjetër. Në përgjigje Znj.           dëshmoi

*"Po. Vetëm Pali. Ai ishte shefi".*

Gjykata konkludon se vendimi i Znj.           për të punuar në Kosovë ishte për shkaqe financiare. Ajo ishte financiarisht e ndjeshme dhe varej nga i pandehuri i dytë për të cilin punoi fillimisht. Duket nga faqja e shënimeve të Western Union-it dhe Unioni Financiar Union se ajo i dërgonte familjes para në Moldavi. Kur u mbyll AS-i dhe kur shkoi të punoi tek i pandehuri i parë ajo ngeli ekonomikisht e ndjeshme dhe tani varej nga i pandehuri i parë.

I pandehuri i parë ishte në pozitë autoritative ndaj           , të cilin autoritet ai e keqpërdori në mënyrë që ta shfrytëzonte atë ashtu që ajo të kryente shërbime seksuale për klientët e tij.

Pajtimi i viktimës së trafikimit me persona në shfrytëzim me dashje është jo relevant. Si do që të jetë, pajtimi nuk ishte real në kuptimin se Znj.           ishte ekonomikisht e ndjeshme. Po të mos pajtohej ajo do të kishte pak zgjedhje

përpos se të kthehej në Moldavi.

Gjykata konkludon se [ ] ishte punësuar nga i pandehuri i dytë si kamarriere. Nuk pati dëshmi të paraqitura para kësaj gjykate se gjatë punësimit të saj në AS i pandehuri i dytë ti ketë kërkuar asaj që të kryente shërbime seksuale. Kur AS-i pushoj së vepruari shkoi të punoi për të pandehurin e parë. I pandehuri i parë ishte në pozitë autoritative karshi [ ] dhe ai ka keqpërdorur këtë autoritet për të shfrytëzuar [ ] e cila ishte ekonomikisht e varur ekonomikisht nga ai dhe shfrytëzohej dhe se e shfrytëzonte atë për përfitime të tija materiale.

[ ] dëshmoi se në Janar 2007 ajo foli me [ ] i cili i propozoi asaj që të punonte si kamarriere për të pandehurin e parë.

Ajo tha se para se të arrinte në Kosovë ajo kishte marrë me faks kontratën. Kushtet e kontratës ishin që ajo ndër të tjera do të punonte si kamarriere dhe do të merrte pagën mujore prej 150 Eurove.

Me arritjen e saj në Kosovë në aeroport atë e priti i pandehuri i parë dhe e dërgoi në një shtëpi në Gjakovë. Ajo filloi punën në West Park ditën tjetër. Ajo punonte nga ora 6 pasdite deri në mesnatë.

Ajo dëshmoi me 10 Maj 2007<sup>24</sup> se pasi që punoi një javë si kamarriere dhe valltare ajo filloi të jepte shërbime seksuale për klientët. Ajo tha se ofroi shërbime seksuale për afro 20 klientë.

Si përgjigje për pyetjen e mbrojtjes Znj. [ ] dëshmoi

*"...po ta dija se do më duhej të bëja gjëra të tjera përpos punës së kamarrieres nuk do të vija në Kosovë."*

Ajo u pyet nga Prokurori se a kishte folur ndonjëherë me klientët. Ajo u përgjigj duke dëshmuar

*"ne nuk flasim me klientë sepse ne nuk flasim Shqip dhe neve nuk na lejohet kjo gjë. Ishte gjithmonë Pali"*

---

<sup>24</sup> Gjatë ekzaminimit të datës 17 Prill 2007 ajo tha 10 deri në 15 klientë.

*i cili fliste me ta dhe më pas ai na thoshte neve që të bëheshim gati dhe të shkonim me ta."*

Kur e pyeti prokurori se a është angazhuar me dëshirë në ofrimin e shërbimeve seksual për klientët Znj. dëshmoi

*"Gjithmonë ishte pa dëshirën tonë. Ishte e obligueshme jo sepse pronari i "West Park-ut" Pal Pitaqi më urdhëronte, por se ai do të me thoshte "ose puno ose kthehu në vendin tende". Edhe pse pa dëshirën time ishte gjithashtu për shkak të kushteve ekonomike që më detyronin të futesha në shërbime seksuale".*

Kur u dëgjua me 17 Prill 2007 Znj. dëshmoi

*"kur fillova te punoja si kamarriere, Pali me pyeti nëse përveç punës si kamarriere une do të kryeja edhe shërbime seksuale për myshterinj të interesuar, dhe për këto shërbime ai më ofroj 50 përqind të çmimit të pranuar. Unë vullnetarisht pranova, sepse kisha interes."*

Ajo dëshmoi se nuk e ka pa të pandehurin e parë duke marr para nga klientët. Megjithatë, ajo deklaroi se kishin ra dakord se ajo do të merrte 50% të parave që i pandehuri i parë merrte nga klientët për shërbime seksuale që ajo kryente. Ajo tha se nuk kishte marr asnjë para nga i pandehuri i parë.

Kur u dëgjua me 17 Prill 2007 Znj. dëshmoi

*"myshterinjtë gjithmonë përzgjidheshin nga Pali, ai gjente myshterinjtë dhe më pyeste "a pajtohesh të dalësh me myshteri," dhe unë pajtohesha, dhe më pas Pali me qonte në hotel me veturë, dhe vinte të më merrte në mëngjes."*

Me 17 Prill 2007, në përgjigje të pyetjes së bërë nga avokati mbrojtës ajo dëshmoi

*"kurdo që dilja me klientë të cilët zgjidheshin nga Pali unë gjithmonë shkoja vullnetarisht, sepse ashtu ishte marrëveshja jonë paraprake, asnjëherë nuk jam frikuar nga Pali, sepse nuk kisha arsye të frikohesha sepse Pali gjithmonë më trajtonte mua dhe vajzat e tjera mirë."*

dëshmoi se financiarisht ishte e varur nga i pandehuri i parë. Ajo tha

*"Mua dhe vajzave të tjera na jepnin para vetëm për cigare dhe pije, ndërsa ushqimin e kishim të siguruar nga pronari".*

Kur dëshmoi me 17 Prill 2007 ajo tha

*"para se të filloja të punoja për Pal Pitaqaj ia kisha borxh 600 Euro, shpenzimet e udhëtimit nga Moldavia në Kosovë dhe kur fillova të punoja për te unë gradualisht ja paguaja borxhin dhe tani Pali më ka borxh mua 395 Euro"*

Kur ajo dëshmoi me 22 Maj 2008, duke iu referuar në veçanti i pandehuri parë dëshmoi

*"...unë ia dërgova paratë që ajo të mund të vinte në Kosovë. Ia dërgova afro 600 Euro dhe atë për biletë kthyesë...i thashë kur arriti në Kosovë se duke punuar për mua ti do të mi kthesh paratë pak nga pak. Unë nuk e kam obliguar apo detyruar atë të dilte me klientë"*

I pandehuri i parë më pas mohoi ti kishte dërguar para asaj për shpenzime të udhëtimit. Ajo ishte gënjeshtër.

I pandehuri i parë ia pagoi Znj. shpenzimet e udhëtimit. I pandehuri i parë kërkoi asaj që të ia kthente këto shpenzime nga të ardhurat e saja.

Znj. besonte se do të punonte si kamarriere në lokalet e të pandehurit të parë. Ajo dëshmoi *"...po ta dija se do të më duhej të beja gjera të tjera përveç të qenit kamarriere nuk do të vija në Kosovë."* Ajo tha se kryente shërbime seksuale për klientët e West Park-ut. Ajo tha se ishte *"gjithmonë pa dëshirën tonë"*. Edhe ajo ishte në pozitë të ndjeshme ekonomike.

Në deklaratën e saj të 8 Prillit 2007, lidhur me lirin e saj të lëvizjes, ajo deklaroi

*"ne mund të dilnim në qytet por vetëm kur e pyesnim Palin dhe ai na lejonte"*

I pandehuri i parë ishte në pozitë autoritare ndaj saj, të cilin autoritet ai e keqpërdori për ta shfrytëzuar ashtu që ajo të kryente shërbime seksuale për klientët e tij. Në këtë mënyrë ai e shfrytëzoi atë për përfitime të veta materiale.

Pajtimi i viktimës së trafikimit me persona në shfrytëzim me dashje nuk është relevant. Si do që të jetë pajtimi nuk ishte real në kuptimin se Znj. ishte ekonomikisht e ndjeshme.

Gjykata konkludon se i pandehuri i parë pagoi shpenzimet e udhëtimit për në Kosovë. Ajo u mashtrua nga i pandehuri i parë duke besuar se po vinte në Kosovë që të punonte si kamarriere. Kur arriti i pandehuri i parë kërkoi nga ajo të kryente shërbime seksuale për klientët e West Park-ut. ishte ekonomikisht e dobët dhe e varur nga i pandehuri i parë. Ai ia pagoi asaj shpenzimet e udhëtimit dhe asaj iu kërkua që ti paguante ato shpenzime nga të ardhurat e saja. Këto të ardhura përfshinin paratë që ajo fitonte duke kryer shërbime seksuale për klientët e të pandehurit të parë I pandehuri i parë ishte në pozitë autoritative karshi dhe ai e keqpërdori këtë autoritet që të përfitonte nga ajo.

## **2. I pandehuri i Dytë**

u punësua nga i pandehuri i dytë si kamarriere. Ajo tha se kishte kontratë. Kontrata iu dërgua asaj përmes faksit në Moldavi. Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo filloi të punonte në AS një ditë pas arritjes së saj. Ajo tha se kishte liri lëvizjeje.

Ajo tha se punoi për të pandehurin e dytë për afro 6 muaj. Ajo mohoi të ketë qenë e detyruar nga i pandehuri i dytë për të pasur marrëdhënie seksuale me klientë.

punoi për të pandehurin e dytë në kafenenë "AS" për afro gjashtë muaj. Gjatë kësaj kohe ajo tha se nga ajo nuk u kërkua të kryente shërbime seksuale për klientët.

Ajo u kthye në Kosovë në Tetor 2006. Ajo fillimisht punoi për të pandehurin e dytë në AS. Biznesi ndërroi pronar e gjithashtu edhe ajo më pas punoi në West Park.



tha se se ajo ishte bindur që të vinte në Kosovë nga . Qartazi ekzistonin disa lidhje në mes të pandehurës së tretë dhe sepse transferimet e parave të gatshme të shumës së përgjithshme prej 400 Eurosh ishte kryer nga e pandehura e tretë tek në Prill 2007. Këto transferime u bënë pasi që Olga Cutu kishte arritur në Kosovë. Se a ishte kjo pagesë për për të rekrutuar ? Asnjë dëshmi nuk është paraqitur para kësaj gjykate se e pandehura e tretë përmes kishte rekrutuar Znj. .

dëshmoi se asaj ia kishte mbushur mendjen të vinte dhe të punonte si kamarriere në Kosovë. Ishte shembulli i Prokurorisë se me 1 dhe 2 Shkurt 2007 e pandehura e tretë beri dy transfero në shumë totale prej 1200 Eurosh e cila shumë kishte për qellim të paguante shpenzimet e tyre të udhëtimit. Megjithatë, Gjykata konkludon se arriti në Kosovë në Janar 2007 - para këtyre transferime gjegjëse. Në fakt, për gjashtë muaj para arritjes së në Kosovë e pandehura e tretë beri dy transferime<sup>25</sup> përmes Western Union-it te në shumën e përgjithshme prej 350 Eurove.

Në të vërtetë, dëshmoi se i pandehuri i parë ishte ai që ia pagoi asaj shpenzimet e udhëtimit. I pandehuri i parë mohoi të këtë kërkuar nga e pandehura e tretë që të transferonte para në emër të saj.

Asnjë prove nuk u paraqit para kësaj Gjykate se e pandehura e tretë përmes kishte rekrutuar . Në këto rrethana, Gjykata konkludon se nuk pati dëshmi më pas të paraqitura para kësaj Gjykate se e pandehura e tretë kishte kryer veprën sipas nenit 139 të KPPK-së.

#### **4. E Pandehura e Katërt**

dhe dha dëshmi se atyre ua kishte mbushur mendjen që të vinin në Kosovë dhe në të vërtetë. Nuk pat prova para gjykatës se e pandehura e katërt kishte bërë transferime të

<sup>25</sup> 10 Nëntor 2006 dhe 8 Janar 2007.

parave ose te apo te . Në të vërtetë, nuk pati prova të vene para kësaj gjykate se e pandehura e katërt ose personalisht apo si pjesë e një grupi të organizuar të kishte qenë e lidhur në trafikim as e as .

Nuk pat më pas prova para kësaj gjykate se e pandehura e katërt as vetëm e as si bashkë-kryese të ketë kryer veprë penale nga Neni 139 e KPPK-së.

Akuza 4 - Mundësim Prostitucioni sipas Nenit 201 (1), (2) dhe (3) sipas Nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës.

Sa i përket të pandehurit të parë dhe të dytë.

Sipas Nenit 201 kushdo që me dijeni rekruton, organizon apo ndihmon një person tjetër apo i siguron lokalim një personi tjetër për qëllime të prostitucionit do të dënohet me gjobë apo me dënim me burg deri në tre vjet. Kur vepra kryhet brenda sipërfaqes prej të një shkolle apo vendi tjetër që përdoret për fëmijët, kryesi do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite. Kushdo që me forcë, me kërcënim të forcës, apo duke e mbajtur një tjetër person në situatë varësie personale apo ekonomike që detyron personat e tillë të lidhen në prostitucion do të dënohet me burg prej një deri në tetë vite burgim.

#### **1. I Pandehuri i Parë**

ishte punësuar si kamarriere në West Park. Ajo tha se ajo punoi atje vetëm për afro një javë. Ajo mohoi të ishte detyruar nga i pandehuri i parë të kishte marrëdhënie seksuale me klientë.

kthehet në Kosovë në Tetor 2006. Fillimisht ajo punoi tek i pandehuri i dytë në AS. Më pas ajo punoi tek i pandehuri i parë në West Park ku edhe atje u punësua si kamarriere.

Në pergjigjen e saj ndaj pyetjes së parashtruar të Prokurorit lidhur me atë se a kishte shërbime të tjera që iu kërkuan dëshmitares të kryente, duke iu referuar të pandehurit të parë, Znj. deshmoi .

*"kamARRIERJA duhet të kryej edhe shërbime të tjera që i ofron pronari i kafenesë West Park"*

Ajo dëshmoi

*"...Pal shkante dhe bisedonte me klientë ndryshëm që ishin të ulur në tavolina dhe pasi që binte dakord me ta ai na thoshte të visheshim dhe të shkonim me ta"*

Në deklaratën e saj të 8 Prillit 2007 ajo tha

*"Pali gjithmonë i zgjidhte myshterinjtë..."*

...

*"Parat gjithmonë i merrte Pali dhe mendoj se ai i merrte nga 100 Euro nga klienti"*

Ajo tha se paguhej ekstra për të kryer këto shërbime.

*"Për çdo marrëdhënie seksuale që ti ke, më thoshte Pali, ti do të marrësh 50 Euro dhe unë do të marr 50 Euro si pronar i kafenesë"*

Ajo dëshmoi se gjatë kohës që punoi te i pandehuri i parë ajo pat marrëdhënie seksuale me afro 15 klientë. Kur u dëgjua me 17 Prill 2007, lidhur me periudhën kohore të më hershme prej 6 - 7 muajve ajo llogariti të kishte qenë me 5 apo 6 klientë.

Kur dëshmoi me 17 Prill 2007 ajo tha

*"Kur arrita në Kosovë, pronari i kafenesë Pal Pitaqi më pyeti nëse përveç punës së rregullt si kamariere do të bëja edhe punë të tjera- prostitucion, unë pranova këtë propozim dhe kështu fillova të merresha me prostitucion përpos punës sime si kamariere."*

Lidhur me ngjarjet e 7 Prillit 2007 Znj. dëshmoi:

*"...atë natë Pali erdhe tek ne në kafene dhe na tha të visheshim. Ne u veshëm, merrem xhaketat dhe ai na tha të shkonim të uleshim në veturë. Ne shkuam me veturë në Hotel Metropol në Gjakovë."*

Kur Prokurori e pyeti se kush bisedoi me klientët në

tavolinë Znj.           dëshmoi

*"Pali ishte ai që nisi dhe u morë vesh. Aleksandri hyri, u ulë dhe pastaj u largua, ndërsa Pali ishte ai që na dergoi në hotel"*

...

*"ne ishim të parat që arritëm te hyrja bashkë me Palin. Pastaj Pali u largua me veturë, pastaj arritën klientët dhe ne u ngjitëm me ta lartë"*

Ajo dëshmoi se nuk e ka pa të pandehurin e parë duke marr para.

Znj.           e pyeti prokurori nëse i pandehuri i parë apo i dytë kërkoi nga ajo që të kryente ndonjë shërbim tjetër. Në përgjigje e saj Znj.           dëshmoi

*"Po. Vetëm Pali. Ai ishte shefi".*

dëshmoi se me të arritur në Kosovë ajo takoi në aeroport të pandehurin e parë dhe më pas ai e dërgoi në një shtëpi në Gjakovë. Ajo do të qëndronte aty me vajza të tjera. Ajo filloi punën në West Park ditën tjetër. Ajo normalisht punonte nga ora 6 pasdite deri në mesnatë.

Ajo dëshmoi<sup>26</sup> se pas një jave pune si kamarriere dhe valltare ajo filloi të bënte shërbime seksuale për klientë. Ajo tha se ju ofroi shërbime seksuale afro 20 klientëve. Gjate marrjes në pyetje me 17 Prill 2007 ajo tha diku prej 10 dhe 15 klientëve.

Prokurori e pyeti atë nëse ndonjëherë ka biseduar me klientë. Në përgjigjen e saj ajo dëshmoi

*"ne nuk bisedonim me klientë sepse ne nuk dinim shqip dhe nuk na lejohej kjo gjë. Gjithmonë ishte Pali ai që bisedonte me ta dhe më vonë ai na thoshte të bëheshim gati dhe të shkonim me ta."*

Kur ajo u degjua me 17 Prill 2007 Znj.           dëshmoi

---

<sup>26</sup> Ekstrakti nga dëshmia e kesaj dëshmitareje është nga shqyrtimi I dates 10 Maj 2007 perveq në rastet kur thuhet ndryshe

*"kur fillova të punoja si kamarriere, Pali më pyeti nëse përpos punës si kamarriere a do të kryeja edhe shërbime seksuale për myshterinjtë e interesuar dhe se për këto shërbime ai më ofroi 50 përqind të shumës së marrëveshjes. Unë vullnetarisht pranova, sepse ishte në interesin tim."*

Në deklaratën e saj të datës 8 Prill 2007 ajo tha

*"Pali zgjidhte klientët çdo herë"*

Ajo dëshmoi se nuk e ka pa të pandehurin e parë duke i marrë paratë nga klientët. Megjithatë, ajo dëshmoi se ishin marrëveshje që ajo do të merrte 50% të parave që i pandehuri i parë merrte nga klientët për shërbime seksuale që ajo kryente. Ajo tha se ajo nuk morri asnjë para nga i pandehuri i parë.

Kur u degjua me datë 17 Prill 2007 Znj. \_\_\_\_\_ dëshmoi

*"Myshterinjtë gjithmonë zgjidheshin nga Pali, ai i gjente myshterinjtë dhe më pyeste "a pajtohesh me dalë me myshteriun," dhe unë pranoja, dhe më pas Pali më dërgonte në hotel me veturë, dhe vinte të më merrte në mëngjes."*

Lidhur me natën e datës 7 Prill 2007 Znj. \_\_\_\_\_ dëshmoi se të dy edhe i pandehuri i parë edhe i pandehuri i dytë ishin të pranishëm në West Park. Ajo tha se i pandehuri i parë foli me klientët. Ajo përshkroi se si i pandehuri i parë e shoqëroi atë dhe \_\_\_\_\_ për në Hotel Metropol.

Me datë 17 Prill 2007 ajo dëshmoi

*"...me 7 Prill 2007, Pali na tha se ne duhet të shkonim në hotel, sepse kishim dy klientë, dhe ne shkuam me veturë në hotel "Metropol" në Gjakovë. Ne menjëherë u nisem drejtë dhomave në 7 kat të hotelit."*

## **2. I Pandehuri i Dytë**

u punësua nga i pandehuri i dytë si kamarriere. Ajo tha se kishte kontratë të cilën ia kishin dërguar me faks në Moldavi. Paga e saj mujore ishte 150 Euro. Ajo filloi punën në AS një ditë pas arritjes. Ajo tha

se punonte për të pandehurin e dytë për afro 6 muaj. Ajo mohoi të kishte qenë e detyruar nga i pandehuri i dytë për të pasur marrëdhënie seksuale me klientë.

arriti në Kosovë herën e parë në Shkurt 2006. Ajo mbeti këtu për afro gjashtë muaj para se të kthehej në Moldavi. Gjate kësaj kohe ajo punoi te i pandehuri i dytë në AS. Ajo tha se asaj nuk i është kërkuar që të bënte shërbime seksuale për klientë. Ajo u kthye në Kosovë në Tetor 2006. Për një periudhë të shkurtër kohore ajo punoi për të pandehurin e dytë në AS para se të punonte për të pandehurin e parë në West Park. Gjatë asaj kohe që ajo punoi për të pandehurin e dytë ajo tha se nuk është kërkuar nga ajo që të kryente shërbime seksuale për myshterinjtë.

Kur i pandehuri i dytë e mbylli AS-in në fund të vitit 2006 vajzat e punësuarat tek ai kaluan në West Park.

Nuk ka dyshim se sipas dokumenteve për regjistrim West Park-u ishte në pronësi të të pandehurit të parë. Gjykata dëgjoi provat që ishin pjesë e grupit Dardania. However, although West Park was owned by the First Defendant the question inevitably arises as to what extent, if at all, the Second Defendant was actively involved in the day-to-day activities of West Park. This is a factual issue.

Kur dha dëshmi me 10 Maj 2007, duke iu referuar ngjarjeve të dates 7 Prill 2007 Znj.           dëshmoi:

*"...atë natë Pal erdhi tek ne në kafene dhe na tha që të visheshim. Ne u veshem, morrem xaketat dhe ai na tha që të ulemi në veturë. Ne shkuam me vetur te Hotel Metropoli në Gjakovë.*

Kur Prokurori e pyeti se kush bisedoi me klientet në tavolinë Znj.           dëshmoi

*"Pali ishte ai i cili nisi dhe lidhi marreveshjen. Aleksandri hyri, u ulë dhe pastaj u largua, ndersa Pali ishte ai që na dergoi në hotel"*

Znj.           u pyet nga Prokurori se a kishte kërkuar nga ajo i pandehuri i parë apo i dytë që të kryente ndonjë shërbim seksual. Në përgjigje Znj.           dëshmoi

*"Po. Vetem Pali. Ai ishte shef".*

Prokurori e pyeti atë se a ishte i pandhuri i parë dhe i dytë prezent kur ajo punoi në kafene. Në përgjigje ajo deshmoi

*"Po, ata ishin të ulur në tavolinë bashkë, po më pas Pali shkoi të bisedoi me klientë e tij"*

Në të vërtetë, në dëshminë e saj të dhënë me 10 Maj 2007 Znj. u pyet lidhur me rolin e të pandehurit të dytë lidhur me aktivitetin e tij të ditë pas ditshëm në West Park. Në përgjigje ai deshmoi.

*"Ai thjeshtë vjen, rrin dhe shkon. Ai ishte shefi i mëhershëm. Ai nuk kishte far roli të posaqëm në West Park..."*

ishte punësuar nga i pandhuri i parë në West Park. Kur ajo dha dëshmi me 10 Maj 2007 ajo u pyet lidhur me të pandehurin e dytë

*Prokurori: "A vinte ndonjëherë Aleksander Pitaqi në kafene?"*

*Znj. : " Po, kohë pas kohe"*

*Prokurori: "a e ke parë ndonjëherë Aleksandrin duke biseduar me klientë apo duke marr para nga ta, apo duke i detyruar kamARRIERET per të ndërmarrë ndonjë gjë?"*

*Znj. : "Jo, unë nuk kam fol asnjëherë me te. Ne vetem përshendeteshim, ai rrinte atje por unë nuk e kam pa atë duke folur me klientë"*

*Prokurori: "A ka fol ai me vajzat e tjera per ju?"*

*Znj. : "Jo, kurdo që vinte ai bisedonte vetem me Palin. Ai pinte ndonjë gjë dhe çdo herë ai paguante pijën"*

I pandhuri i parë dha dëshmi se la femrat e punësuar të West Park-ut të mbikqyrura ku u largua per kohë të shkurt pas ores 6 pasdite të datës 7 Prill 2007. Ai tha se nuk u kthye në kafene deri pas orës 11 të mbrëmjes. Gjykata konkludon se kjo ishte thjeshtë e paqëndrueshme. Në të vërtetë, dëshmia e dhënë nga i pandhuri i parë dhe i dytë

lidhur me kete eshte kontradiktore.

Kur dëshmoi me datë 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë dëshmoi se arriti në West Park rreth orës 9.15 të mëmjes dhe qëndroi shumë pak. Megjithatë, kjo kundërshtoi dëshminë e të pandehurit të parë i cili tha se i pandehuri i dytë ishte akoma në West Park kur ai u kthye në ora 11 të mëmjes.

Në deklaratën e tij të datës 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë tha se ai bisedoi vetëm me të pandehurën e tretë. Kjo ishte gënjeshtër. Ai qart mund të shihet në incizimet e fshehta të DVD-së të bëra nga policia me 7 Prill 2007 në bisedë me oficeret policor në detyrë të fshehtë

dëshmoi lidhur me ngjarjet e 7 Prillit 2007 kur së bashku me Oficerin , ai ishte pjesë e dytyres së fshehtë operative policore në West Park.

Oficerët kishin të montuara pajisje të fshehta për incizime audio dhe video. Incizimet e DVD-së të bëra gjatë operacionit të fshehtë janë futur në dëshmi nga Prokurori.

Kur dha dëshmi me 02 Maj 2007 Oficer tha

*"Aleksandri na ofroj neve shërbime, ai na pyeti se a donim një vajzë rrinte me ne në kafene apo dëshironim marrëdhënie seksuale"*

Oficeri dëshmoi se ata kërkuan marrëdhënie seksuale

*"...ai u përgjigj se është 100 Euro për një femër nga ora 24.00 deri në ora 08.00..."*

Gjatë dëshmisë së tij me 2 Maj 2007 Oficeri përshkroi negociatat e tij me të pandehurin e dytë dhe se i kishin paguar para të pandehurit të dytë për shërbimet seksuale.

Oficer dëshmoi

*"...Aleksandri e urdhëroi atë të qonte vajzat me veturë në motel, ai mori vajzat dhe i përcolli ata nga pas me veturë".*

Ishte e paqartë se kujt po i referohej Oficeri kur tha se i pandehuri i dytë e urdhëroi "atë". Si do që të jetë, Gjykata konkludon se ai po i referohej të pandehurit të

parë. dhe dëshmuar se ishte i pandehuri i parë ai cili i dërgoi ato në Hotel Metropol.

I pandehuri i parë madje dha dëshmi kontradiktore lidhur me këtë gjë. Kur ai dëshmoi me 17 Maj 2007 i pandehuri i parë deklaroi se pas punës të dy vajzat e "lutën" atë që ti dërgonte në Hotel Metropol. Ai deklaroi se ai i dergoi me veturë në hotel, doli nga vetura dhe i përcolli të dy vajzat deri te dera e hotelit. Kur dëshmoi para kesaj gjykate ai tha se nuk hyri me veturë në parkingun e hotelit. Ai tha se u ndal në rrugë dhe se të dy vajzat zbriten. Ai tha se nuk zbriti nga vetura. Kjo ishte gënjeshtër.

Në deklartën e 19 Prillit 2007 Faton Syla deklaroi se ishte i pandehuri i parë ai të cilin ky e pa duke qëndruar përjashta hotel Metropol Hotel - edhe pse më pas ai e ndryshoi dëshminë e tij - në ante në fjalë kur vajzat dhe Oficer dhe arritën.

Kur dha dëshmi me 02 Maj 2007 përshkroi se bisedoi me të pandehurin e dytë. Ai dëshmoi

*"Pronari erdhi, ai u prezantua si Aleksander..."*

Ai u pyet lidhur me bisedën e tyre me të pandehurin e dytë. Në përgjigje oficer dëshmoi

*"Aleksandri nap yeti nese dëshironim shërbim në tavolinë apo donim të kishim seks"*

Oficeri vazhdoi

*"Pronari njoftoi se tarifa per një kamarriere ishte 100 Euro"*

Oficeri dëshmoi se ata paguan paratë kur u larguan nga kafeneja. I pandehuri i dytë morri bankontën prej 100 Eurosh dhe dy banknote prej 50 Eurosh për të dy vajzat. Ishte e qartë nga biseda e Oficerëve me të pandehurin e dytë se shërbimet seksuale jepeshin në një lokal tjetër. Duke iu referuar të pandehurit të dytë oficeri dëshmoi

*"...ai na tha, unë kam punëtorin tim dhe ju përcjelleni atë në motelin që ai shkon."*

Në dëshminë e tij, oficeri deklaroi

*"Në hotel në të cilin ne hymë bashkë me femrat nga vetura para nes, keto femra ishin me Pal Pitaqin"*

Kur u more në pyetje nga policia me 19 Prill 2007 Faton Syla u pyet se sa here në të kaluarën ai kishte pa të pandehurin e dytë para hotelit duke sjellë vajza. Në përgjigjen e tij ai tha

*"...unë merresha vetëm me mysafirët që kërkonin dhomë por gjatë kohës kur unë hapa derën unë shihja femra dhe meshkuj ndërsa e kam pare me veturë Aleksander Pitaqin shumë herë.."*

Kura i u more në pyetje nga policia me 19 Prill 2007 ai u pyet se sa here përpos natës së 7 Prillit 2007 ai kishte pa të pandehurin e dytë para hotelit. Në përgjigje Ztr. Syla deklaroi

*"Gjithashtu gjersa hapja deren për mysafirë me femra unë e kam pa Palin në hotel disa herë"*

Në deklaratën e tij të datës 19 Prill 2007 Ztr. Syla iu referua një rasti kur dy femrat qëndruan në hotel për 5 ditë. Ai u pyet nese e dinte se ku punonin vajzat. Në përgjigjen e tij ai tha

*"Po, njera nga to qëqëndroi në hotel për pesë ditë ishte punëtorja e Aleksandrit dhe Palit..."*

Dëshmia e dhënë nga ishte se i pandehuri i pare dhe i pandehuri i dytë rregullisht i dërgonin punëtorët femra në Hotel Metropol me qëllim që ato të kishin marrëdhënie seksuale me klientë. Kjo ishte saktësisht menyra e veprimit që i ndodhi me 7 Prill 2007.

Gjykata po ashtu konkludoi se me date 7 Prill 2007 ishte i pandehuri i dytë ai i cili negocioj me policet me mission të fshehtë dhe ran dakord që të siguronin dhe për police me mission të fshehtë me qëllim të ofrimit të marrëdhënieve seksuale me ato vajza. Ishte i pandehuri i dytë ai i cili mori paratë për keto sherbime të qëllimshme seksuale. Ishte i pandehuri i pare ai që dërgoi me veturë dhe në Hotel Metropol me dije me qëllim që ato të kishin marrëdhënie seksuale me dy police me mission të fshehtë.

Gjykata konkludon se me datë 7 Prill 2007 në lokalet e West Park-ut, në fshatin Lug Bunar, Komuna e Gjakovës, i pandehuri i pare dhe i pandehuri i dytë, në bashkë-veprim, me dijeni rekrutoi dhe organizoi me qëllim të prostitucionit.

Gjykata konkludon se lokalet e West Park-ut gjendeshin Brenda sipërfaqes më të vogël se 350 metra nga shkolla Rushdim Ahdemi, fshati Lug Bunar. Mbrojtja e të pandehurëve pohoi se për shkak se lokalet e West Park operonin në kohën kur shkolla nuk ishte në pushim faktit se lokalet e West Park-ut ishin brenda rrezes/sipërfaqes prej 350 metra të shkolles nu është relevante. Kjo ishte në njëfar mënyre një argument i pasinqertë. Neni 201 (2) është qartë.

Nuk pati dëshmi të tjera se ndonjera nga vajzat e punësuar në West Park ishin subjekt i forces fizike, apo të kërcënimit që të siguronte shërbime seksuale për klientët e West Park-ut.

dha dëshmi se asaj "dhe vajzave të tjera" u jepeshin vetëm para për ciagere dhe pije, gjersa ushqimin për to e siguronte i pandehuri i pare. Kjo dop të mbështeste rastin e prokurorisë së mbahej nga i pandehuri i pare në pozitë varësie ekonomike. Megjithatë, dëshmia e saj lidhur me këtë ishte kontradiktore nga dëshmitarë e tjerë.

Akuza 2 - Pastrim Parash sipas Seksionit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 e përmirësuar me Rregullorene e UNMIK-ut 2006/53 siq parashihet me Nenin 23 të Kodit penal të Kosovës.

Sa i përket të pandehurit të dytë, të pandehures së tretë dhe të katërt.

Elementet konstituiv të veprës penale të Pastrimit të Parave (Seksioni 11.2 i Rregullores së UNMIK-ut No. 2004/2, Neni 10.2 (d), e përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2006/53), janë se I pandehuri e dinte ose kishte arsye të dinte se prone e caktuar është rrjedhim në njëfarë forme i veprimtarisë kriminale dhe se prona në të vërtetë është rrjedhë e krimit.

Veç kësaj, Prokuroria duhet të dëshmoi se i pandehuri, vetëm apo me iniciatic të përbashkët, e

konvertoi/transferoi pronën me qëllim të fshehjes apo maskimit të natyrës/burimit/dispozites/ lëvizjes së pronësisë, apo duke ndihmuar ndonjë person i cili është i përfshirë në të apo qëllimisht është përfshirë në kryerjen e veprës penale-e cila prodhoi pronën në mënyrë që ti shmanget pasojave të veprimeve të saja/tija, apo duke ndihmuar më tej veprimin penal të nënvizuar.

#### **1. I pandehuri i Dytë**

I pandehuri i dytë ishte pronari i AS-it. Ai tha se e mbajti kafenene për 5 - 6 muaj. Pastaj ai e mbylli kafenenë dhe vajzat e punsuara tek ai u kaluan tek West Park.

Nuk pat prova të paraqitura para kesaj gjykate per ndonjë veprim të paligjshëm të jetë kryer nga i pandehuri i dytë në lokalet e AS-it. Vajzat e punsuara te i pandehuri i dytë kaluan në West Park me date ose para dates 1 Nëntor 2006.

Gjykata gjeti se i pandehuri i dytë ishte aktivisht i kyçur në veprimtarit e ditë për ditshme të West Park-ut. Kjo ishte një ndërrmarje e përbashkët e të pandehurit të pare dhe të dytë.

Ishte shembulli i Prokurorisë se transferimet e parave në mes Kosovës dhe Moldavisë të bëra nga apo në emër të të pandehurit të dytë ishin burim ng akrimi dhe se i pandehuri i dytë në ndërmarrjen e bashkuar transferoi ata para për qëllim të fshehjes apo maskimit të burimit të tyre në mënyrë që ti shmanget pasojave per veprimet e tija penale.

Ishte rasti i të pandehurit të dytë që parat kishin burim nga veprimtarit e biznesit ilegal.

I pandehuri i dytë dëshmoi me 22 Shkurt 2011 se që nga citi 2000/2001 ai merrej me biznes të shitjeve të veturave. Ai tha se shiti diku prej 5 dhe 10 vetura në vit. Ai mendon se përfitimi për secilen veturë në regjion ishte 200 - 800 Euro. Ai tha se nuk ishte I regjistruar për shkaqe të tatimit.

Gjykata dëgjoi dëshmitë nga dëshmitar të ndryshëm të thirrur nga i pandehuri i dytë lidhur me veturat të cilat ata I kishin blerë nga i pandehuri i dytë gjatë periudhes kohore 2003 - Shkurt 2006.

Përpos verures së gjoja blerë nga në Shkurt të 2006 veturat e tjera ishin shitur disa vite para dates së kryerjes së këtyre veprave penale.

Përpos shitjes së veturave i pandehuri i dytë dëshmoi se shiste pemë dhe perime në tregun e vendit. Nuk ka dëshmi të future në shënime mbi të ardhurat që kanë rrjedhur nga ky biznes. Edhe ky biznes nuk është regjistruar për shkak të tatimeve.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se të ardhurat e tij në vitin 2006 rrjedhnin nga AS-i, shitja e veturave dhe nga tezga në treg. Në vitin 2007, të ardhurat e tij të vetme ishin nga shitja e veturave dhe nga tezga në treg. Nuk pat dëshmi të paraqitura para kësaj gjykate për shitje të veturave nga ana e të pandehurit të dytë për periudhen kohore Mars 2006 - Prill 2007. Nuk pati dëshmi të paraqitura para kësaj gjykate për përfitimet e nxjerrura nga veprimtaria me tezgë në treg.

I pandehuri i dytë, si pronar i kafenesë "AS" deklaroi të ardhurat për periudhen TM4<sup>27</sup>/2005 dhe TM1/2006. Tatimi është tërhequr nga burimi nga Nëntori 2005 deri në Maj 2006 dhe Pensionet<sup>28</sup> nga Dhjetori 2005 deri në Janar 2006. Nuk u paraqiten dëshmi para gjykates për asnjë deklaram tjetër të tatimit që ishte kryer.

Për periudhën 03/2006 qarkullimi i deklaruar i "AS-it" ishte 1,132 Euro.

Prokurori futi në dëshmi përmbledhjen e shumës së xhirrollogarisë së të pandehurit të dytë të Kasabankes. Gjatë periudhës Dhjetor 2006 - Prill 2007 veprimtaria e gjithmbarshme në atë xhirrollogari ishte afërsisht 38,000 Euro. Janë bërë tri deponime të rëndësishme: 15,000 Euro në Dhjetor 2006; 10,000 Euro në Mars 2007 dhe 13,000 Euro në Prill 2007.

Lidhur me deponimin e 15,000 Eurove në Dhjetor 2006 një shënim në deklaratën e Kasabankës thotë "deponim për blerje të shtëpisë dhe tokës- Aleksander Pitaqi".

Lidhur me deponimin e 10,000 Eurove në Mars 2007 një shënim në deklaratën e Kasabankës thotë "Deponim i Aleksander

---

<sup>27</sup> Periudhë tre-mujore/një çerek

<sup>28</sup> Mbase fonde pensionale

Pitaqi". Kura i dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se parat ishin të nënës së tij.

Lidhur me deponimin e 13,000 Eurove në Prill të 2007 një shënim i deklaratës së Kasabankës thotë "Deponim i avokatit ( ) për Aleksander Pitaqi për shitblerje të shtëpisë dhe tokës".

Lidhur me xhirrollogarinë e tij në Kasabank i pandehuri i dytë dëshmoi me 23 Maj 2008 se ai morri perms Western Union shumë prej 5000 Eurosh nga dhëndri i tij. Raportet e Unionit Financiar i referohen një transferi prej 5000 Eurosh nga një dërgues në Gjermani në Nëntor të 2006.

Janë pesë tërheqje të rëndësishme nga xhirrollogaria: 15,000 Euro me 6 Dhjetor 2006; 1,000 Euro me 28 Mars 2007; 1,000 Euro me 30 Mars 2007; 1,000 Euro me 31 Mars 2007 dhe 20,000 Euro me 30 Prill 2007.

Lidhur me tërheqjen e 15,000 Eurove me 6 Dhjetor 2006 shënimi i deklaratës së Kasabankës thotë "transferim i mjeteve në emër të shitblerjes së patundshmërisë-shitës , blerës Aleksander Pitaqi, komuna e Gjakovës, rruga M. ".

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Eurove me 28 Mars 2007 shënimi i deklaratës së Kasabankës thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Euros me 30 Mars 2007 shënimi i deklaratës së Kasabankës thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 1,000 Euros me 31 Mars 2007 shënimi i deklaratës së Kasabankës thotë "tërheqje nga Aleksander Pitaqi."

Lidhur me tërheqjen e 20,000 Eurove me 30 Prill 2007 shënimi i deklaratës së Kasabankës thotë "Transferim i mjeteve në emër të shitblerjes së patundshërisë, parcela no.1247/1, shtëpi dhe oborr me sipërfaqe 0.01045 ha, komuna e Gjakovës."

Nga 38,000 Eurot e deponuara në xhirrollogarin e të pandehurit të dytë në Kasabank gjatë periudhës Dhjetor 2006 - Prill 2007 35,000 Euro janë përdorur për blerje të pronës në Gjakovë.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 ai tha se kishte pranura shuma të tjera parash nga dhëndri I tij në Gjermani. Ai tha se disa nga paratë ishin dërguar perms motrës së tij. Atij nuk i kujtohet shuma e parave të marra apo datat se kur i mori keto para.

Shënimet e Unionit Financiar si dhe Western Union mbi të cilat prokuroria mbështeti provat transferime të ndryshme janë bërë nga e pandehura e tretë. Dokumentet e siguruara nga PTK-së shënojnë të dhëna të transmetuara të bëra nga përdorimi i telefonit të të pandehurit të dytë.

Me 30 Janar 2007 në ora 1400 i pandehuri i tretë dërgoi perms Western Union te shumën prej 3000 Eurosh. Numri kontrollues i transferimit ishte 938896090. Me 30 Janar 2007 në ora 13.07 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi ky thjeshtë thuhej "9383896090" e që ishte numri i transferimit.

Me 9 Shkurt 2007 në ora 1100 e pandehura e tretë dërgoi përmes Western Union te Shumen prej 500 Euro. Numri kontrollues i transferit ishte 8713885779. Me 9 Shkurt 2007 ora 10.07 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi ku thuhet "8713885779" e që është numri i transferit.

Me 26 Mars 2007 në ora 0840 e pandehura e tretë dërgoi përmes Western Union te Shumen prej 200 Euro. Numri kontrollues i transferit ishte 8343870900. Me 26 Mars 2007 në ora 07.50 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi ku shkruhet vetëm "8343870900" e që është numri i transferit.

Me 28 Mars 2007 në ora 0830 e pandehura e tretë perms Western Union-it I dërgoi shumën prej 1700 Euro. Numri kontrollues i këtij transferi ishte 9134162319. Me 28 Mars 2007 në ora 0801 dhe në ora 0802 i pandehuri i dytë dërgoi sms të njejtë në Moldavi ku thjeshtë thuhet "9134162319, 1700 Euro".

Me 29 Mars 2007 në ora 1120 e pandehura e tretë përmes Western Union-it I dërgoi shumën prej 100 Euro. Numri kontrollues i transferit ishte 4255646906. Me 29 Mars 2007 në ora 1034 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi ku thjesht thotë "4255646906" e që është numri i transferit.

Me 30 Mars 2007 në ora 1335 e pandehura e tretë dërgoi perms Western Union-it te shumën prej 200 Eurove. Nurmi kontrollues i transferimit ishte 35598444057. Me 30 Mars 2007 në ora 1243 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi kuy thjeshtë thuhet "35598444057" e që është numri i transferit.

Me 3 Prill 2007 në ora 1420 e pandehura e tretë dërgoi perms Western Union-it te shumën prej 300 Eurove. Numri kontrollues i transferit ishte 3183912343. Me 3 Prill 2007 në ora 1334 i pandehuri i dytë dërgoi një sms në një numër në Moldavi ku thjeshtë thotë "Veronika Dragan dërgon 300 Euro, 3183912343".

Gjatë periudhës kohore 1 Nëntor 2006 - 7 Prill 2007 i pandehuri i dytë personalisht transferoi në Moldavi përmes Western Union-it shumën totale prej 3,150 Eurosh. Nga kjo shumë, 3,100 Euro iu dërguan të pandehures së tretë.

Sipas shënimeve të Unionit Financiar, gjatë periudhës kohore 1 Nëntor 2006 - 7 Prill 2007 e pandehura e tretë transferoi shumën totale prej 10,900 Euro në Moldavi. Gjykata konkludon se nga keto transferime 6,000 Euro janë bërë nga e pandehura e tretë në emër të të pandehurit të dytë.

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë tha se ai dhe e pandehura e tretë po planifikonin të blenin një apartament në Moldavi. Kjo mbase mund të jetë e vërtetë. Ai tha se deri më tani paratë nuk janë investuar në patundshmëri në Moldavi.

I pandehuri i dytë është një kriminel i cili është i përfshirë së paku në një biznes ilegal. Gjykata ka shiqura të gjitha burimet e mundshme ligjore të të ardhurave dhe konkludoi se shuma prej 9, 150.00 Eurove të transferuara në Moldavi gjatë periudhës kohore prej 1 Nëntori 2006 - 7 Prill 2007 kishte burimin nga krimi, që do të thotë nga prostitucioni.

Gjykata konkludon se i pandehuri i dytë, me iniciativë të përbashkët me të pandehuren e tretë, transferuan para te pranues të ndryshëm në Moldavi me qëllim të fshehjes apo maskimit të prejardhjes së parave, dhe duke vepruar kështu u përpoqën ti shmanget pasojave të veprimit të tij dhe në këtë mënyrë kreu veprën penale sipas Seksionit 11.2 të

regullores së UNMIK-ut No. 2004/2, Neni 10.2 (d) (siq është përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2006/53)).

## **2. E Pandehura e Tretë**

E pandehura e tretë hyri në Kosovë në Shtator të 2005. Ajo punoi si kamarriere në restaurantin "Dina". Ajo dëshmoi me 1 Tetor 2007 se paga e saj ishte 150 - 200 Euro në muaj. Ajo dëshmoi se ajo mund të merrte 60 - 100 Euro në ditë. Ajo u largua nga Kosova me 11 Dhjetor 2005.

Sipas shënimeve të unionit Financiar, gjatë periudhes kohore 1 Nëntor 2006 - 7 Prill 2007 e pandehura e tretë transferoi shumë tërësi totale prej 10,900 Eurosh në Moldavi. Gjykata gjen se nga këto transferime 6,000 Euro janë bërë nga e pandehura e tretë në emër të të përndhurit të dytë.

E pandehura e tretë u pyet lidhur me këto transferime që ajo bëri te pranuesit në Moldavi dhe për paratë që ajo morri. Aja dha sqarime të ndryshme lidhur me qëllimet e këtyre parave. Ajo tha se ajo po ashtu pranoi para nga i pandehuri i dytë. Ajo dëshmoi "*unë kasha rrogë dhe dashnorin që më ndihmonte*".

Mbrojtja e të pandehures së tretë futi në dëshmi përkthimin e një ekzemplari nga Raporti i Këshillit Konsultativ Mjekësor të Institutit për Mjekësi dhe Sanitari Publike të Qendrës së Mjekëve Familjar të Republikës së Moldavisë të datës 19 Shkurt 2009 që vërtetonte se e ëma e të pandehures së tretë ishte diagnostifikuar nga hepatiti kronik. Ishte rasti I tretë I të pandehures së tretë që paratë e transferuara në Moldavi ishin për trajtimin e së ëmës së saj në spital. Nuk u paraqit ndonjë dëshmi para gjykatës për atë nëse ndonjë ishte bërë diagnose apo se I ishte dhënë ndonjë trajtim të ëmës së të pandehures së tretë në kohën apo rreth asaj kohe kur ishin bërë transferimet në fjalë.

E pandehura e tretë është dashmorja e të pandehurit të dytë. Ajo punonte në West Park. Thjeshtë është jo bindëse se ajo nuk e dinte se një pjesë e parave të transferuara që ajo bëri në emër të pandehurit të dytë kishin prejardhje nga krimi, që do të thotë prostitucioni.

Nuk u afruan dëshmi para kësaj gjykate se e pandehura e tretë kishte ndonjë interes financiar në West Park. Ajo nuk

u akuzua sipas Akuzës së 4-të.

Gjykata gjen se e pandehura e tretë, në bashkëveprim me të pandehurin e dytë, transferoi paratë në fjalë tek marrësit në Moldavi me qëllim të fshehjes apo maskimit të prejardhjes së parave, dhe në këtë mënyrë ndihmoi të pandehurin e dytë i cili ishte i përfshirë në mundësimi të prostitucionit që të shmang pasojat e veprimeve të tija, dhe në këtë mënyrë në mënyrë të tërthortë ndihmoi veprimtarin e cekur kriminale.

### **3. E Pandehura e Katërt**

Kur dëshmoi me 22 Shkurt 2011 i pandehuri i dytë deklaroi se ia kishte dhënë të pandehures së katërt afro 3000 Euro për ti transferuar në Moldavi në emër të tij. Megjithatë, është e paqartë nga dëshmitë e Prokurorisë prejardhja e atyre të ardhurave apo saktësisht se kur u kryen ato transferime. Nuk pati dëshmi para kësaj gjykate për ndonjë aktivitet të paligjshëm të kryer nga ana të pandehurit të dytë kur ishte pronar i AS-it.

Në të vërtetë, gjatë periudhës kohore prej 1 Nëntorit 2006 - 7 Prill 2007 e pandehura e katërt transferoi para në Moldavi në shumë totale prej 1020 Euro. Secili transfer i kryer gjatë kësaj periudhe kohore ishte relativisht shumë personale.

E pandehura e katërt nuk është akuzaur sipas Akuzës 4. Nuk pati dëshmi të paraqitura para kësaj gjykate se ajo kishte ndonjë interes financiar në West Park.

Nuk pati dëshmi se paratë e transferuara gjatë periudhës 1 Nëntor 2006 - 7 Prill 2007 u kryenë nga ana e të pandehurit të dytë. Ka gjasa të njejta se transferimet e parave që e pandehura e katërt i bëri gjatë kësaj periudhe ishin nga të ardhurat e saja.

### **D. Përcaktimi i dënimit**

Kur vihet një sanksion penal, gjykata duhet të ketë parasysh qëllimet e përgjithshme të dënimit, duke përfshi këtu edhe ruajtjen, parandalimin si dhe mbrojtjen e

shoqërisë.

Në lëndën aktuale, vepra penale e Trafikimit me Qenie Njerëzore është një vepër e rëndë dhe me arsye meriton një dënim që korrespondon me dënim të rëndë. Veç kësaj, sa i përket Mundësimit të Prostitucionit, edhe pse dënimi me gjobë është gjithashtu i përballueshëm, vetëm dënimi me burg mund të arrij qëllimin e cekur më lart. Natyrisht, lidhur me veprën penale të Pastrimit të Parave dënimi do të jetë me burgim dhe gjobë.

Këto ish-in raste të rënda të veprave penale të kryera gjatë një periudhe kohore. Lidhur me Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqi, rrethanat rënduese janë dërmuese krahasuar me ato lehtësuese: në fakt kryesit e veprave treguan përcaktim të veçantë, kryeneçësi si dhe mos keqardhje në kryerjen e veprave penale. Përveç kësaj veprimet penale kërkonin një përgatitje, planifikim dhe zotim kështu që shkalla e përgjegjësisë penale të Pal Pitaqaj dhe Aleksander Pitaqi duhet të konsiderohet si shumë e lartë sepse ata bashkërisht ish-in të përfshirë në veprimtaritë e ditë-pas-ditshme në West Park.

Sa i përket Veronica Dragan është e qartë se ajo e dinte që së paku një pjesë nga të ardhurat e parave që ajo transferoj në Moldavi në emër të të pandehurit të dytë ish-in të ardhura nga një aktivitet jo ligjor.. Prandaj, kjo është një rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit.

Në përputhshmëri me rregullat e llogaritjes së dënimit të bashkuar, dënimet do të jenë si në vijim:

sa i përket Pal Pitaqaj:

dënimi për veprën penale të *Trafikimit me Qenie Njerëzore* është katër vite burgim; dënimi për veprën penale *Mundësim i Prostitucionit* është dy vite burgim; dënimi i unifikuar, sipas rregullave për dënim të veprave penale bashkekzistuese/të njëkohshme/ është pesë vite burg;

sa i përket Aleksander Pitaqit:

dënimi për veprën penale *Pastrim Parash* është tre vite burg dhe gjoba prej 12.000 Eurosh; dënimi për veprën penale *Mundësim i Prostitucionit* është dy vite burg; dënimi i unifikuar, sipas rregullave për dënim të veprave penale bashkekzistuese/të njëkohshme/ është katër vite burg dhe gjoba prej 12.000 Euro;

sa i përket Veronica Dragan:

dënimi për veprën penale *Pastrim Parash* është dy vite burg dhe gjoba prej 6.000 Euro; Kundër Veronica Dragan do të vihet dënim dytësor, pasi që ajo është e huaj dhe ka kryer vepër penale në territorin e Kosovës.

Koha që është kaluar në paraburgim gjyqësor llogaritet në dënimin e të pandehurve.

#### **E. Shpenzimet**

Sipas Nenit 102 paragraf (1) lidhur me Nenin 99 paragraf (1) dhe (2) nën paragraf (6) të KPPK-se, duke dënuar të pandehurit Pal Pitaqaj, Aleksander Pitaqi dhe Veronica Dragan, ata duhet të kompensojnë shpenzimet e këtyre procedurave gjyqësore penale në shume prej 1.000 € secili dhe paushallin gjyqësor në shume prej 200 € secili.

Sipas Nenit 102 paragraf 2 të KPPK-se, lidhur me këto vepra penale për të cilat të pandehurit janë liruar dhe shpenzimet e tyre ligjore në mbrojtje, kjo pjesë e procedurave gjyqësore penale do të përcaktohet dhe hiqet nga shpenzimet që ata urdhërohen ti paguajnë.

Siçshtet Nenit 103 paragraf 1 të KPPK-se, Elena Pislaru duke qenë se është liruar nga të gjitha Akuzat, shpenzimet e saja ligjore do të kompensohen nga Buxheti i Shtetit.

#### **F. Padi për Kompensim**

Palët e dëmtuara nuk ishin të pranishme në shqyrtim kryesor dhe nuk ishin të përfaqësuar. Sipas Nenit 108 paragraf 1 të KPPK-së, Palët e Dëmtuara kanë të drejtë të ushtrojnë kundër të pandehurve Pal Pitaqaj, Aleksander Pitaqi padi pronësore.

Për arsyet e cekura deri më tani lëshojmë këtë aktgjykim.

Me datë 6 Prill 2011.

---

Gjyqtari Malcolm Simmons  
Kryetar i Trupit Gjykses



---

Gjyqtar Riku Jaakkola

Gjyqtare Elmaze Syka

---

Tarik Mripa  
Procesmbajtës

Këshillë Juridike: Sipas Nenit 398(1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë, personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë ndaj këtij aktgjykimi Brenda pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të parashtrohet në formë të shkruar nëpërmes Gjykses se Qarkut në Peje për Gjykatën Supreme të Kosovës.

